



ASPEKTE TË MENDIMEVE TË IMAM KHOMEINIT

(përmbledhje esesh)

Përktheu:

MEHDI ZEJNELI

Parathënie

Imam Khomeini ishte një nga ato personalitete që i dhanë trajtë historisë. Jeta e tij mund të ndahet në tri periudha. Periudha e parë është ajo e studentit të teologjisë, dijetarit dhe më pas autoritetit të lartë fetar (*marxha'*).

Imam Khomeini u lind më 24 Shtator 1902 në Khomein. Ai i përkiste një familjeje dijetarësh fetarë të përzotshëm. Kur ishte pesë vjeç, babai i tij u vra nga Reza Shahu. Kështu, në edukimin e tij, përzotshmëria dhe devotshmëria fetare u përzinë me një urrejtje ndaj tiranëve, diktaturës dhe imperializmit. Këto pesë karakteristika vazhduan të jenë tiparet kryesore të personalitetit dhe mendimit të tij.

Në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare, Imam Khomeini shkoi në Hauze (shkollë tradicionale e mësimin të lartë fetar) për arsimim. Në fillim ai studioi në Arak e pastaj në Kom, nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Ajetullah Abdul Kerim Hairit, themeluesit të Hauzes moderne të Komit.

Pasi u diplomua në Teologji Islame, ai u bë dijetar e profesor i spikatur dhe botoi disa vepra. Ai ishte gjithashtu një shtyllë e administrimit dhe e organizimit të klerikëve shi'itë në Kom dhe në mbarë Iranin. Nën udhëheqjen e Ajetullah Buruxherdiut, Imam Khomeini u bë *marxha'*. Periudhën e dytë të jetës, Imam Khomeini e fillon si reformator shoqëror dhe revolucionar politik.

Lëvizja politike e Imam Khomeinit kundër tiranisë së brendshme dhe imperializmit të jashtëm filloi në dhjetëvjeçarin e viteve 1960', kur Shahu lançoi "Revolucionin e Bardhë". Shahu e bëri këtë për ta dërrmuar Islamin nga Irani dhe për ta zëvendësuar me kapitalizmin dhe kapitullimin para imperializmit. Shahu ishte bërë vegël e Amerikës dhe aleat i Izraelit. Çifutët mbizotëronin politikën iraniane, megjithë faktin se 98% e iranianëve janë myslimanë. Imam Khomeini nisi një sulm fshikullues ndaj regjimit tiran të Shahut nga foltoret e Medresesë Fezije. Më 10 Muharrem, ai mbajti fjalimin e tij historik. Në fillim ai u burgos, por kjo shkaktoi zemërim publik. Prandaj, Shahu e dëboi Imam Khomeinin, në fillim në Turqi e pastaj në Nexhef të Irakut.

Në Nexhef, i cili ishte qendër madhore e diturisë sikurse edhe Komi, Imam Khomeini iu përvesh kërkimeve, mësimdhënies dhe udhëzimit shpirtëror të shi'itëve, duke përhapur gjithashtu mesazhin e tij revolucionar. Në vitet 70', ndikimi i Imam Khomeinit u rrit ndjeshëm në Iran dhe ai u bë një forcë mbizotëruese. Vdekja e Mustafait, birit të tij më të madh, dhe botimi i një artikulli shpifarak kundër tij, shpërtheu demonstrimet. Kjo lëvizje u përhap si flaka e shkurreve dhe nxiti Revolucionin. Imam Khomeini shkoi në Neapple de Chateau në Francë dhe e udhëhoqi revolucionin së andejmi. Revolucionin e flaku tej regjimin e fuqishëm të Shahut dhe Imam Khomeini erdhi në Iran me mikëpritjen më të madhe në histori. Kështu përfundoi periudha e dytë e jetës së Imam Khomeinit. Kjo periudhë karakterizohet nga një përpjekje e paepur kundër tiranisë së brendshme dhe diktaturës së egër të Shahut, si dhe kundër imperializmit të jashtëm të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik të atëhershëm. Ai

përhapi idealin e shtetit islam dhe idenë se feja s'mund ta shpërfillë politikën dhe se politika duhet të ndërtohet mbi bazat e fesë.

Periodha e tretë e jetës së Imam Khomeinit fillon pas ngadhënjimit të Revolucionit Islamik të Iranit. Në këtë periudhë ai është ndërtues i kombit, udhëheqësi suprem që përgatiti një grup nxënësish që e çuan përpara revolucionin. Ai është gjithashtu burim frymëzimi për lëvizjen fetare dhe të përshtirshme në mbarë botën dhe jo vetëm në mesin e myslimanëve, por edhe grupeve të qytetërimeve të tjera. Së fundi, por jo nga rëndësia, është se ai mbetet personi që i dha një kuptim të ri konceptit të paangazhimit. Ai sfidoi si Amerikën, ashtu edhe Rusinë Sovjetike dhe tregoi që nëse një komb është gjallues dhe i frymëzuar nga një ideal, ai mund të sfidojë fuqinë më të madhe mbi dhe. Forca e fesë dhe e masave do ta ruajë atë nga mësimet e imperializmit global. Ky është një mësim për historinë, që duhet kujtuar në të gjitha periudhat por sidomos në epokën e unipolarizimit. Imam Khomeini është një pishtar drite për tërë popujt e nëpërkëmbur dhe të gjitha kombet që duan të mbrojnë pavarësinë e tyre.

Së fundi, më duhet t'i shpreh mirënjohjen më të thellë pararendësve të mi që e mundësuan botimin e këtij libri dhe falënderimet e sinqerta për studiuesit që kontribuan me punimet e tyre akademike.

Xhelal Tamleh
Drejtor i Qendrës Kulturore të Iranit,
Nju Delhi

Opinionet e Mendimtarëve Politikë Muslimanë mbi Monarkinë dhe Imam Khomeini

S. M. Azizuddin Husein

Politika islame u shfaq me themelimin e Medinës si qendra e pushtetit, më 622 e.s. Ajo mbështetej në dy referenca kuranore, (i) “Bindjuni Zotit dhe bindjuni Profetit dhe bindjuni atyre me autoritet mes jush” dhe “zgjidhni çështjet tuaja me konsultim”. Sipas Muhamed Ikbalit, “Ajo kërkon besnikëri ndaj Zotit, e jo ndaj fronit.” Dhe, meqë Zoti është baza e përfundme shpirtërore e jetës, besnikëria ndaj Zotit nënkupton pothuajse besnikëri ndaj vetë natyrës së tij ideale. Sipas K.A. Nizamiut: “Republika e Medinës i zbatoi këto parime në praktikë. Të gjitha çështjet zgjidheshin pas diskutimeve të hapta dhe këshillimeve të lira, në të cilat mund të merte pjesë gjithkush, pavarësisht nga statusi i tij. Në këto këshille fjala e Profetit nuk kishte fuqi vendimmarrëse, përveçse kur fliste me autoritetin e Kuranit.¹ Nuk kishte klasë qeverisëse atëherë, e as njerëz të nënshtruar. Në ligjëratën e tij të fundit në Mekë, Profeti Muhamed (pqmt) shpjegoi organizimin social-politik të Islamit. “Arabi nuk është i epërm ndaj joarabit, joarabi nuk është i epërm ndaj arabit. Nëse një sakat abisinas ka autoritet mbi ju dhe ju udhëheq sipas Librit të Allahut, bindjuni atij.” Muhamed Habibi e diskutoi natyrën e Shtetit islam që u ngrit gjatë periudhës së Profetit Muhammed. “Dallimet raciale nuk kanë kurrfarë vlere; të gjithë janë të barabartë; të gjithë janë vëllezër; as ligji e as opinionin shoqëror nuk duhet të bëjnë dallime ndërmjet fisnikut dhe të thjeshtit. E drejta e njeriut për personin e vet, për të prodhuar punën e vet dhe për reputacionin e karakterit që ai ka fituar, është aq e shenjtë dhe e paçmueshme sa edhe më e shenjta e Mekës. Asnjë shtet, kurrfarë paragjykimesh fanatike apo interesash partiake mund të lejohen t’i shkelin ato; e keqja urrehet. Nuk ka monopol të posteve të pushtetit; nuk ka mbretër, oligarki; nuk ka kler. Më i përluëti i skllëvërve ka po aq të drejtë të jetë kreu i Shtetit sa edhe kurejshi më fisnik. Nuk ka ‘pari’ apo kasta të ulëta.”

Pas vdekjes së Profetit Muhamed (pqmt) më 632 e.s., muslimanët mbetën pa udhëheqës, duke qenë se Profeti Muhamed nuk e kishte zgjidhur çështjen e pasuesisë së tij.² Duke vepruar sipas direktivës kuranore - ‘zgjidhni çështjet tuaja me *shura* dhe *ixhma* (këshillime të ndërsjellta dhe njëzëshmëri) dhe bindjuni atyre që kanë autoritet në mesin tuaj.’ Muslimanët e kishin zgjedhur Ebu Bekrin si kalif të Profetit Muhamed (pqmt). Kjo gjendje vazhdoi gjatë periudhës së Omerit, Osmanit dhe Aliut, pra deri më 661 e.s. Tiparet kryesore të këtij Shteti ishin sovraniteti i ligjit, drejtësia për të gjithë njerëzit e Shtetit dhe se të gjitha burimet e thesarit shtetëror duheshin përdorur për mirëqenien e popullit.

Mirëpo me hypjen e Muavijes në pushtet më 661 e.s., republika islame u kthye në *mulukijet* (monarki e trashëguar). Tiparet e republikës islame u zëvendësuan me monarkinë e trashëguar, epërsia e ligjit u sfidua dhe filloi mbizotërimi i diskriminimit fetar, rajonal e racor. Muavija i ktheu umejadët në një klasë sunduese. Nuk mund të

bihet dakort me K.A. Nizamiun kur pohon se “Me zhvillimet që po ndodhnin në jetën politike të myslimanëve, kjo ishte bërë pothuajse e pashmangshme.” Ai është i mendimit se në këtë kohë muslimanët tanimë kishin devijuar nga rruga politike e Islamit. Shteti islam filloi si një shtet demokratik, impresionues dhe i hapur ku kryetari i tij përgjigjej para bashkësisë së myslimanëve. Në kushtet historike që filluan të mbizotëronin në Arabi, këto u shndërruan në një sundim tejet shtypës, byrokratik dhe despotik gjatë mesjetës ndërkohë që kushtet historike dhe marrëdhëniet bashkë me forcat e prodhimit ndryshuan. Ulemave (dijetarëve fetarë) dhe teoricienëve politikë iu desh t’i modifikonin në mënyrë të volitshme teoritë e tyre për t’u shkuar për shtat kushteve të reja historike.

Shumica e dijetarëve, juristëve dhe teoricienëve politikë myslimanë gjatë umejadëve dhe abasidëve u ndikuan nga gjendja që mbizotëronte në atë çast. Pikëpamjet e Mavardiut mbi teorinë politike, të parashtruara në *el-Ahkam us-Sultanie*, qenë përpjekja e parë në mesin e muslimanëve për të paraqitur një teori të shtetit islam. Ai e ndikoi thellësisht mendimin politik musliman. Teoria politike e Imam Gazaliut përfshinte tre elementë: kalifin, sulltanin dhe ulematë. Ai e përktheu termin kuranor nga ajeti 4:59 – *ulil amr*, në emirë, pra sundimtarë të përkohshëm. Kështu, shohim se edhe Gazaliu madje e ligjëroi monarkinë, për të cilën nuk kishte patur vend në praktikën e Profetit Muhamed (pqmt) dhe kalifëve të udhëzuar. Ibn Tejmije e pranoi sulltanin si hija e Zotit. Ai gjithashtu ishte i mendimit se madje edhe një sundimtar i padrejtë ose i paditur duhet ndjekur. Edhe Ebu Jusufi nuk parashtron ndonjë kontroll mbi pushtetin absolut të kalifit. Nizam ul-Mulk et-Tusi që ishte nën ndikimin e monarkisë sasanide, nuk u shqetësua për këtë. Ai kishte mbështetur çfarëdolloj opinionin që ishte mbajtur nga ulematë e hershëm. Lloji i sistemit shoqëror që kishte në mendje Nizam ul-Mulk et-Tusi është feudal. El-Bakilani ishte i interesuar për të hedhur poshtë argumentet e sekteve dhe të grupeve që kërcënonin vazhdimësinë e qeverisjes ligjore të paraqitur nga sunnitë. El-Farabiu ishte i interesuar për arritjen e lumturisë nëpërmjet jetës politike dhe me marrëdhëniet ndërmjet regjimit më të mirë dhe ligjeve hyjnore të Islamit. Ai i ndante qytetarët në tri kategori mbi bazën e dijës. Farabiu kishte ndikuar gjithashtu dijetarë të mëvonshëm si Ibn Sina, Ibn Rushd, Fahrudin Razi dhe të tjerë. Ibn Halduni gjithashtu e pranoi monarkinë për sa kohë të mos kishte dhunim të drejtësisë.

Në Indi jemi me fat të kemi veprën e Ziauddin Baraniut mbi teorinë politike, *Fetava-i Xhahandari* dhe një traktat tjetër mbi teorinë politike, *Zakhiret ul-Muluk* e Mir Sejjid Ali Hamadaniut. Në argumentin e tij, Baraniu përlligj kthimin e kalifatit në *mulukijet*; ndonëse në të njëjtën kohë (për shkak të ndjenjave të tij) ekzistonin pohime kontradiktore mbi monarkinë. Një *alim* i shekullit të katërmëdhjetë përlligj sundimtarët tejet shtypës, byrokratik dhe despotikë të periudhës mesjetare. Hamadaniu e përkufizon një sundimtar të mirë të Shtetit si një person që (1) kishte cilësitë e *enbija* (profetëve) dhe *evlija* (shenjtorëve), (2) që nuk ka qëndrim të egër ndaj popullit dhe nuk i shkel kufijtë e *Sheriatit*. Ai që nuk i ka këto cilësi dhe i kundërvihet Sheriatit është me të vërtetë një armik i Zotit dhe i Profetëve. Ai e quan një lloj të tillë sundimtari ‘Kalif i Shenjtanit’. Në këtë mënyrë, Hamadaniu është në mopajtim të plotë me të tjerë mendimtarë politikë muslimanë si Ibn Tejmije dhe Baraniu.

Nëse hetojmë titujt e punimeve që u shkruan gjatë periudhës mesjetare, do të shohim se ata janë mjaft domethenës. Librat që shkruheshin mbi politikën mbanin tituj

si *al-Ahkam us-Sultanie, Nasihat ul-Muluk, Zahiret ul-Muluk, Fetava-i Xhahandari, Edeb ul-Mulk, Dhikr ul-Muluk, Suluk ul-Muluk... Riad us-Salihin*, etj. Këta tituj sugjerojnë animin mendor të *ulemave* ndaj *mulukijetit*. Këta *ulema* në përgjithëse shqiptoheshin për *mulukijetin*, në mënyrë që ai të lëshonte rrënjë në shoqërinë muslimane. Dhe, disa mendojnë e besojnë se *ulematë* kishin patur sukses në përpjekjen e tyre.

Sadruddin Hasan Nizamiu, Fahr-i Mudabbir Amir Khosrovi, Hasan Sixhizi, përdornin për sundimtarët tituj si Zililah fil Alemin, Zile Jazdani dhe Saja-i Jazdan-i Pak.

Ulematë që bënë çmosin për ta legjitimizuar monarkinë nuk mundnin gjithashtu që ta bënë një ligj të tillë të detyrueshëm për muslimanët. Ndaj, çështja e kalimit trashëgimor të monarkisë u zgjodh mbi bazën e fuqisë. Në veprën e tij *Matla ul-Anvar*, Amir Khosrovi thonte me të drejtë se:

*Nuk merret fronti mbi bazën e monarkisë
Veçse dhe derisa të goditet me shpatë*

E njëjta pasiguri si dhe dështimi i ligjit të trashëgimisë në mesin e myslimanëve pasqyrohej gjithashtu nga komentet e një udhëtari francez Bernier, i cili vëzhgon: “Në pjesën tonë të globit, marrja e frontit i jepet djalit më të madh përmes ligjesh të urta dhe të pandryshueshme, por në Hindustan e drejta e qeverisjes zakonisht diskutohet nga tërë bijtë e monarkut të vdekur, çdonjëri nga të cilit reduktohet në flijimin e vëllait të vet, që të sundojë për vete, ose në vuajtjen e flijimit të jetës së tij për sigurinë dhe stabilitetin e sundimit të një tjetri.” Kjo sugjeron dështimin tërësor të ligjit të trashëgimisë ose kalifatit e parashtruar nga themeluesit e teorisë politike muslimane.

Ebul Fazli e ka përkufizuar titullin e Padishahut më këto fjalë: “Madje edhe kuptimi i fjalës Padishah e tregon këtë, pasi Pad d.t.th stabilitet dhe zotërim, ndërsa Shah do të thotë origjinë, mbret. Një perandor është pra, origjina e stabilitetit dhe e zotërimit.” Ebul Fazli gjithashtu e përkufizoi mbretërinë me fjalët: “Mbretëria është një dritë që buron nga Zoti dhe një rreze nga dielli, ndriçuesi i gjithësisë, argumenti i librit të përsosjes, mbartësja e virtyteteve. Gjuha moderne e quan këtë dritë, drita hyjnore dhe gjuha e lashtësisë e quajti atë holoja sublime. Ajo u komunikohet mbretërve nga Zoti pa ndihmën ndërmjetëse të askujt, dhe njerëzit, në prani të saj, përkulin ballin e madhërimit drejt dheut të nënshtrimit.”

Edhe Irani sundohej nga monarkët. Monarkia iraniane madje vazhdoi deri në vitin 1979 dhe bota myslimane arabe ka ende monarki trashëgimtare. Qartësia mbi natyrën e shtetit islam ishte tepër e ngatërruar. Pozita si ajo e Sulltanit, Padishahut, Shahinshahut dhe Shahut pranoheshin si islame në natyrë dhe karakter. Në Indi, që nga shekulli 13-të deri në mesin e shekullit të 20-të nuk u shkrua asnjë këndvështrim i ri mbi shtetin islam, as në arabisht, as në persisht. Një përpjekje u bë nga Mevlana Sejjid Ebul Ala Meududi. Ai e shkroi librin e tij në urdisht nën titullin *Hilafet-o-Mulukijet*. Shumica e *ulemave* sunni iu përngjitën sulltanëve të Delhit, perandorëve mugalë dhe navabëve. Shumica e *ulemave* shi‘itë iu përngjitën në Indi navabëve të Avadhit, Hajderabadit dhe

Rampurit. *Ulematë* shi'itë rrallëherë mbanin ndonjë fjalim mbi natyrën e republikës islame nëpër tubimet e muajit Muharrem, përpara 1979-ës.

Imam Khomeini nisi një lëvizje kundër monarkisë pahlaviste në Iran dhe një numër i madh njerëzish flijuan jetët e tyre për ta rrëzuar monarkinë e trashëguar të Shahinshah-i Aria Mehrit. Ai nuk pajtohej me shumicën e mendimtarëve politikë se duhet duruar një sundimtar musliman tiran. Përpara tij, ndër mendimtarët politikë mesjetarë muslimanë Mir Sejjid Ali Hamadaniu është përjashtimi i vetëm që u bën thirrje njerëzve të mos e ndjekin një sundimtar musliman tiran.

Imam Khomeini e rekomandonte luftën kundër Shahut. Ai e vuri theksin mbi rrugët paqësore, duke mbajtur tubime proteste kundër sundimit të tij despotik dhe qëndresë pasive e jo dhunë. Ai e zgjoi sensin e identitetit dhe u riktheu iranienëve kurajon dhe vetëbesimin dhe i inkurajoi ata të mos u bindeshin ligjeve të qeverisë diktatoriale. Për shembull, ai u kërkonte ushtarëve të dezertonin garnizonet dhe popullit të mos paguante taksa. Mendimtarët politikë mesjetarë nuk ua lejonin muslimanëve të vepronin kështu.

Më 1979, Irani u çlirua nga *Mulikijeti* dhe u hodhën themelet e Republikës Islamike. U propozua dhe u përvetësua një Kushtetutë e re nga Kuvendi i Iranit, më 1979. Kjo kushtetutë pasqyron frymën e Kartës së Medinës të vitit 622 e.s. të lëshuar nga Profeti Muhamed (pqmt) dhe *Hutbe Haxhxhatul Vida* (ligjëratën e haxhit të lamtumirës) të mbajtur nga Profeti Muhamed më 632 e.s.

Neni 3 i paragrafit 8 pohon, “pjesëmarrja e të gjithë njerëzve në përcaktimin e fatit politik, ekonomik, shoqëror dhe kulturor.”

Neni 14 thekson “sigurimin e të drejtave të të gjithë individëve, gra e burra, dhe sigurimi i mbrojtjes me ligj për të gjithë dhe barazisë së tërë njerëzve para ligjit.”

Neni 19 thotë se “çdo qytetar individual i kombit, me cilatdo tipare etnike ose fisnore, ngjyre, race, gjuhe ose të ngjashme, nuk do të ketë privilegje dhe nuk do të preferohet.”

Neni 154 thotë, “Republika Islamike e Iranit aspiron për lumturinë e qenies njerëzore brenda bashkësisë dhe i njeh pavarësinë, lirinë dhe sundimin e drejtësisë si të drejta universale që duhen gëzuar nga tërë popujt e botës. Në përputhje me këtë, ndërkohë që përmbahet nga ndërhyrja në punët e brendshme të kombeve të tjera, Republika Islamike do të mbështesë çdo përpjekje të drejtë të popujve të deprivuar kundër klasave shtypëse kudo përmbi dhe.”

Neni 13 thotë se “zoroastrianët, çifutët dhe të krishterët iranienë janë të vetmet pakica fetare të njohura në fushën e ligjeve islame dhe janë të lirë të kryejnë ceremonitë e tyre fetare. Në çështjet personale dhe mësimet fetare, ata mund të veprojnë në përputhje me diktatet e vetë ligjeve të tyre fetare.” Shumica e mendimtarëve politikë muslimanë nuk pajtohen me ofimin e lirisë fetare ndaj *dhimmi*-ve (jomuslimanëve).

Neni 12 thotë se “feja zyrtare e Iranit është Islami dhe shkolla zyrtare e tij është ajo xhaferite e 12 Imamëve, dhe ky nen është i pandryshueshëm përgjithmonë. Shkollat e tjera të Islamit qofshin hanefi, maliki, shafi, hanbeli dhe zejdi konsiderohen me respekt të plotë dhe ndjekësit e këtyre shkollave gëzojnë liri të plotë në kryerjen e ritualave të tyre fetare sipas jurisprudencës së tyre dhe në lidhje me udhëzimet e tyre fetare, statusin personal (përfshi martesën, divorcin, trashëgiminë dhe bërjen e testamentit) dhe çështjet e lidhura me to konsiderohen zyrtare në gjykata. Në çdo rajon ku ndjekësit e cilëso prej këtyre shkollave përbëjnë shumicën, rregullat lokale do të formulohen sipas udhëzimeve të juridiksionit të këshilleve të atij rajoni me sigurimin se të drejtat e ndjekësve të shkollave të tjera do të ruhen.” Një liri e tillë nuk u ofrohet shkollave të tjera muslimane në disa vende muslimane si Arabia Saudite. Mund të jesh pasues i cilitdo medhheb por në Arabinë Sauditë duhet të ndjekësh Islamin saudit. Natyra dhe karakteri i qeverisë së Arabisë Saudite është monarkia e trashëguar, e cila është joislame. Gjatë periudhës së Zia ul-Hakut në Pakistan, mbi muslimanët u vendos zekati. Mirëpo përsa i përket përqindjes së pagimit të zekatit, ka dallime në shkollat e ndryshme të jurisprudencës muslimane. Muslimanëve që i përkisnin shkollës shi‘ite iu kërkua gjithashtu të paguanin zekatin sipas ligjit hanefi.

Neni 6 thotë se “Në Republikën Islamike të Iranit çështjet e kombit duhen kryer sipas votave të përgjithshme të popullit, ose përmes zgjedhjes së presidentit të Republikës, përfaqësuesve të kuvendit islamik, anëtarëve të Këshillit etj, ose përmes referendumit siç sqarohet në nene të tjera të Kushtetutës.”

Neni 3, pika 14 flet për “sigurimin e të drejtave të plota të të gjithë individëve qofshin gra ose burra dhe ofrimin e sigurisë së drejtë ligjore për të gjithë dhe barazisë përpara ligjit.”

Karakteristika më e rëndësishme e Imam Khomeinit ishte se ai qe nga njëra anë besnik ndaj parimeve dhe vlerave fetare, dhe nga ana tjetër një besnikëri e tillë nuk e pengoi të ruante praninë aktive në arenën politike. Kështu, politika e Imamit mbështetej mbi fenë. Ai besonte se politika ishte në njëfarë mënyre përmbushja e moralit fetar.

Imam Khomeini nuk besonte në ndjekjen e shembullit klasik perëndimor të demokracisë. Prandaj, demokracia e Imam Khomeinit u frymëzua nga vlerat dhe morali islam. Ai mendonte të sillte ndryshim në përmbajtjen dhe formën e demokracisë. Objektivi kryesor i Imam Khomeinit ishte konsolidimi i themeleve të jetës politike të iranianeve duke shtruar rrugën për pjesëmarrjen politike të popullit. Ai ishte veçanërisht i ndjeshëm ndaj karakteristikave morale, politike dhe shoqërore të kandidatëve për zgjedhje parlamentare. Ai kërkonte që filantropistë fisnikë, të sinqertë dhe të drejtë të zgjidheshin në kuvend për t’u ardhur në ndihmë atyre që kishin halle dhe për t’i shërbyer mirëqenies së popullit. Ndihmesa e rëndësishme e Imam Khomeinit në modernizimin politik të Iranit ishte të ndihmohej Asambleja Ligjvënëse e Iranit që të bëhej organizatë e pavarur politike e masave, sepse shumë kohë para se ai të dilte si udhëheqës, jo vetëm Irani por krejt bota islame, që më 661 e.s., ishte nën ndikimin e elitës politike dhe një shtrese të veçantë të shoqërisë (*ashraf*). Në sajë të përpjekjeve të tija, Asambleja Iraniane fitoi më shumë forcë për ta mobilizuar opinionin publik që të pranonte reforma shoqërore dhe të gëzonte lirinë.

Referenca:

1. Profeti i Pagabueshëm (pqmt) fliste gjithmonë dhe në të gjitha rastet, me autoritetin e Kuranit. (red.)
2. Shi'itët besojnë ndryshe. (red.)

Ndihmesa e Ajetullah Khomeinit në Ndërtimin e Kombit pas Revolucionit Islamik në Iran

Dr. Muhidin Muslim Khan, Departamenti i Shkencave Politike, Xhamie Milie, Nju Delhi

Revolucioni Iranian (1979) ishte rezultati i një lëvizjeje popullore, qëllimi i vetëm i të cilit ishte rrëzimi i monarkisë. Për këtë arsye, detyra e ndërtimit të kombit iranian në fazën pasrevolucionare ishte më sfiduese. Përveç rishtrimit të problemeve dhe ruajtjes së unitetit e integritetit, ekzistonte edhe domosdoshmëria e ofrimit të një drejtimi të ri për masat dhe një themeli të fortë të autoritetit. Ndihmesa e Ajetullah Khomeinit për këtë detyrë të ndërtimit të kombit qe jo vetëm e madhe, por edhe unike.

Nuk ka dyshim se, ndërkohë që përpjekja kundër Shahut po intensifikohej, Ajetullah Khomeini filloi të merrte një rol të shquar. Me dobësimin e fuqive të Shahut, edhe shtypi ndërkombëtar filloi ta njihnte Ajetullah Khomeinin si 'udhëheqësin' e lëvizjes, ndërkohë që ai filloi të vepronte më haptasi kundër Shahut, nga Parisi. Ai u kthye në Iran më 1 Shkurt 1979, kur Shahu e kishte lënë Iranin, dhe filloi procesin e ndërtimit të kombit. Forcat përkrahëse të Shahut po përpiqeshin shumë që të rivendosnin regjimin e tij. Ekzistonte madje edhe kërcënimi i forcave rajonale dhe centrifugale të cilat po përpiqeshin të shpërthenin pas revolucionit. Një situatë e tillë shtronte sfida të mëdha.

Ajetullah Khomeini u përqëndrua në konsolidimin e Revolucionit, nismën e ndërtimit të institucioneve dhe udhëzimin e masës e të elitës në rindërtimin dhe zhvillimin e fazës pasrevolucionare. Ai nuk e lejoi elitën drejtuese të shmangej nga objektivat e revolucionit.

(a) Rregull nga Kaosi: Qeveri e Përkohshme

Menjëherë pas kthimit të tij, Ajetullah Khomeini vendosi qeverinë e revolucionarëve, për ta nxjerrë Iranin nga kaosi e për të ngritur rendin. Ishte gjithashtu e domosdoshme që të hiqej qeveria kukull e Bahtiarit e instaluar nga Shahu përpara se të braktiste Iranin. U bënë përpjekje që të ruhej uniteti. Ajetullah Khomeini emëroi Mehdi Bazarganin, një aktivist të të drejtave të njeriut dhe demokrat, si kryeministër të ri, më 4 Shkurt 1979. Ajetullah Khomeini i dha gjithashtu Bazarganit bekimet e tija fetare duke deklaruar se kushdo që vepronte kundër tij dhunonte ligjet e shenjta fetare.¹ Disa grupe revolucionare s'ishin të kënaqura. Një njeri shumë i afërt i Ajetullah Khomeinit, Ibrahim Jazdi, u emërua zëvendës kryeministër dhe i ngarkuari me çështjet e Revolucionit. Kabineti i ri përfshinte njerëz si Ahmed Sadr Haxh - Sejjid Xhavadi (Ministër i Brendshëm), demokratë si: Dr. Kerim Sanxhabi (Ministër i Jashtëm) dhe Dariush Faruhar (Ministër i Punës dhe i Çështjeve Shoqërore) dhe teknokratë e shërbyes

civilë të njohur për kompetencat dhe integritetin e tyre, si: Ali Akbar Minfar (Ministër i Buxhetit), Ali Ardalan (Ministër i Financave), Mustafa Katirali (Ministër i Strehimit dhe i Zhvillimit Urban), Jusuf Tahiri Kazvini (Ministër i Rrugëve dhe i Transportit) dhe Dr. Kerim Sami (Ministër i Shëndetësisë).

Por autoriteti i vërtetë në Iran asokohe ishte në duart e Ajetullah Khomeinit, sepse atij i bindeshin krejtësisht në vendimet e tija gjykuese. Njerëzit pritnin shumë prej tij sepse ai ishte projektuar nga kërkesa popullore si udhëheqësi i vetëm i Iranit. Ai u përpoq të përmbushte aspiratat e popullit. Disa nga besnikët e tij më të afërt që i kishin shërbyer në ekzilin e tij, përfshinin mjaft udhëheqës fetarë si dhe iranianë të tjerë si: Sadik Ghotbzadeh (Drejtuës i Radios Shtetërore), Bazargani dhe Ibrahim Jazdiu etj. Ajetullah Khomeini mori fuqi nga mbështetja e jashtëzakonshme popullore, e shpalosur në një sërë demonstratash pro Khomeinit.

Këshilli Revolucionar Islamik

Këshilli Revolucionar Islamik (KRI) kishte filluar të vepronte që kur Ajetullah Khomeini ndodhej në Paris. Ai i kishte siguruar atij mbështetje organizative. Ai autorizoi arrestimet e kundërrevolucionarëve, ngriti gjykatat revolucionare, konfirmoi dënimet me vdekje, organizoi sigurimin dhe siguroi shpërndarjen e artikujve thelbësorë. KRI punoi përmes qindra komiteteve organizative dhe degëve të tyre që vepronin anekënd Iranit. Edhe çështjet e lidhura me kontrollin e armëve dhe të municionit etj., ishin nën kujdesin e KRI.

Gjykatat Islame

Gjykatat islame ishin një tjetër institucion i ri i krijuar nga Ajetullah Khomeini; ndonëse morën 'dënimin' më të madh nga media perëndimore. Këto gjykata kombinonin dy funksione: 1) Gjykimi i fajtorëve mbi bazën e kodit ligjor islam, të mbështetur në Sheriat; 2) Një tjetër funksion i gjykatës ishte që të përpiquej të gjykonte shkeljet e mbështetësve klandestinë të Shahut. Ish-ministra të Shahut, zyrtarë të lartë të SAVAK-ut (policisë sekrete të Shahut) dhe forcave të armatosura, të policisë dhe të byrokracisë u hetuan nga këto gjykata për veprat e tyre të tradhtisë dhe mizorisë. Përfshirja e tyre në tortura, masakra, tradhti dhe korrupsion u hetua nga këto gjykata. Gjyqet u zhvilluan dhe disa prej tyre u transmetuan në televizion. Një numër zyrtarësh të lartë dhe bashkëpunëtorësh të regjimit të Shahut që u gjetën fajtorë, u ekzekutuan. Media perëndimore si dhe disa iranianë ishin shumë kritikues ndaj këtyre gjykatave dhe gjyqeve, por shumica dërrmuese në Iran nuk kishte simpati për të akuzuarit sepse ata urreheshin madje edhe nga sektorë të ndryshëm të opozitës për shkak të rolit të tyre gjatë regjimit të Shahut. Megjithatë, gjykatat u riorganizuan nën drejtimin e KRI dhe jurisdiksioni i tyre u kufizua. Ajetullah Khomeini deklaroi se dënimi me vdekje duhej kufizuar në ata që ishin fajtorë për vrasje të kryera gjatë sundimit të Shahut.²

Riorganizimi i Ushtrisë

Forcat e armatosura të vendit u vunë nën kontrollin e përgjithshëm të Ajetullah Khomeinit për t'u përdorur si instrument në ruajtjen e sigurisë së fazës pasrevolucionare si nga rreziku i brendshëm, ashtu edhe ai i jashtëm. Gjenerali Muhammed Wali Karani, një kritik i hershëm i Shahut, i cili qe burgosur më 1958, u bë shefi i ri i stafit dhe atij iu besua detyra e ndërtimit të ushtrisë Iraniane. Forcat e armatosura me të vërtetë u përdorën kundër kurdëve dhe turkmenëve kur lëvizja e tyre për autonomi filloi të parqiste sërish një kërcënim për integritetin e Iranit. Gjenerali Naser Rafbod që zëvendësoi Karaniun, filloi të organizonte ushtrinë e re mbështetur në orientimin islam.³

Garda Kombëtare

Instrumenti kryesor në ruajtjen sistematike të sigurisë ndaj kundërvënies nga brenda, ishte organizimi i Gardës Kombëtare nga Imam Khomeini. Rojet e armatosura që kishin mbajtur rendin në emër të komiteteve revolucionare u përfshinë në këtë organizatë të re. Pjesëtarëve të grupeve të qëndrësës iu kërkua t'ia dorëzonin armët e tyre Gardës Kombëtare ose të merrnin përsipër përgjegjësitë e tyre duke u trajtuar si kundërrevolucionarë.⁴ Me një ngjyrim islam, Garda Kombëtare u udhëhoq fillimisht nga Ajetullah Lahuti dhe më vonë nga revolucionari islam Hashemi Rafsanxhani i cili u ndihmua nga anëtarët e KRI.

Islamizimi i Medias së Informacionit

Ajetullah Khomeini e kishte kuptuar rëndësinë e medias informative si një instrument fuqie dhe ndërtimi të kombit. Ja përse radioja dhe televizioni u vunë nën kontroll të grupit islamik dhe u përdorën për të përhapur programin e Ajetullah Khomeinit për revolucionin islamik. Censura e shtypit ishte vendosur gjithashtu në Iran. Ajetullah Khomeini kërkonte nga media që ato të pasqyronin një theksim të vërtetë islam e jo të ndiqnin verbërisht modelin perëndimor ose amerikan. Redaktorëve të gazetave iu kërkua të pasqyronin “një theks të mirëfilltë islam” në botimet e tyre.⁵

(b) Krijimi i Republikës Islamike

Në Iran, Islami kishte qenë një forcë aktive kundër monarkisë që nga fillimi i shekullit të njëzetë. Ai u bë boshti i tubimit për protestat kundër Shahut veçanërisht gjatë njëzetepesë viteve që i paraprinë revolucionit. Megjithëse modernizmi kurrë nuk ishte hedhur poshtë krejtësisht nga disa prej udhëheqësve islamikë, lëvizja islamike në Iran ishte në përputhje me modelin themelor. Kjo solli konflikt me forcat sekulariste të cilat gjithashtu ishin zhvilluar në Iran përgjatë një intervali disavjeçar. Por ndërkohë që lëvizja islamike ishte e lidhur ngushtë nga ndërthurja e elementëve si kleri, xhamia dhe popullata myslimane, lëvizja sekulariste nuk ishte e bashkërenditur mirë. Të ashtuquajturat forca sekulare ishin më të larmishme dhe ndikoheshin nga rryma si ‘liberalizmi’, socializmi, marksizmi, Lëvizja e Klasës Punëtore, Lëvizja e Studentëve të Vesternizuar, etj. Forcat sekulare të cilat i kundërviheshin jashtë mase revolucionit, të

rrënjosur thellë dhe të mbështetur mirë, s'arritën dot t'i bënin opozitë të bashkuar lëvizjes islamike në Iran, dhe ato nuk kishin as bazë të madhe në popull. Megjithatë, ato i kundërviheshin individualisht Ajetullah Khomeinit.

Një grup i ri sekularist i quajtur Fronti Demokratik Kombëtar u formua gjithashtu në javën e parë të Marsit 1979, çka u njoftua gjatë një tubimi të disa njerëzve në 12-vjetorin e vdekjes së Dr. Mosadekut. Disa gazeta njoftonin se ky grup kërkonte që në vend të referendumit mbi çështjen e 'Republikës Islame', njerëzit duhen pyetur vetëm mbi heqjen e monarkisë, kurse karakteri i qeverisë së re republikane do të përcaktohej nga një referendum tjetër që duhet të mbahej pas një debati të gjerësishëm kombëtar mbi këtë çështje. Mirëpo në Mars 1979, referendumi i dha mbështetje me shumicë dërrmuese programit të Republikës Islamike të Ajetullah Khomeinit.

Partia Tudeh, me bazën e saj ideologjike komuniste, nuk i tërhoqi masat iraniane që ishin fetare dhe komunizmi u barazua me ateizëm.

Lëvizja e qëndresës nga muxhahedinët ishte fillimisht e kujdesshme nëse jo haptasi kundër Ajetullah Khomeinit, por një tjetër lëvizje qëndrese, ajo e Fajadinëve, iu kundërvu haptasi këtij programi.

Megjithatë, Ajetullah Imam Khomeini, u përpoq t'i heshte kundërshtarët dhe sekularistët duke u bërë thirrje masave që të vendosnin njëherë e mirë natyrën e vërtetë të politikës që duhej të ndiqte Irani, duke votuar në referendum për Republikën Islamike. Ai e kundërshtoi shkrimin e fjalës demokraci përkrah Republikës Islamike si një koncept i Perëndimit dhe i tradhtarëve për të dobësuar Iranin.⁶ Rezultati i referendumit i dha mbështetje të fuqishme Ajetullah Imam Khomeinit ku nga 20 288 021 vota të hedhura, 20 147 055 ishin në favor të Republikës Islamike. Kjo mbështetje nga masat i dha shtysë të jashtëzakonshme vetëbesimit të Ajetullah Khomeinit dhe përpjekjeve të tija për ndërtimin e kombit në Iran në vijë me ideologjinë islamike.

Çështja tjetër më e nxehtë në Iran ishte forma e Kushtetutës së re. Disa kërkonin një debat mbarëkombëtar mbi këtë problem dhe në të njëjtën kohë të mbronin interesat e tyre. Dy drafte u parashtruan në Prill dhe Qershor të vitit 1979: të moderuarit donin një qeveri të drejtuar nga teknokratë me përvojë, ku kleri ofronte udhëzime nga jashtë. Ajetullah Khomeini vendosi të bëheshin zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese. Partia e re Republikane Islamike, e cila përfaqësonte pikëpamjet e Ajetullah Khomeinit dhe Këshillit Revolucionar, fitoi dy të tretat e vendeve të Asamblesë Kushtetuese. Asambleja nuk ishte e tëra muslimane. Ajo që më vonë u bë model, nuk kishte vende të veçanta.

Kushtetuta e re u përgatit nën parametrat udhërrëfyesh të Islamit ku Ajetullah Khomeini ishte *Fekih* (Juristi Suprem). Kjo e bëri Iranin një teokraci. Tri degëve të zakonshme të qeverisjes - legjislativit, ekzekutivit dhe gjykatës - iu shtua një e katërt: Këshilli 12-anëtarësh i Mbikëqyrësve. Këshillit të Mbikëqyrësve iu dhanë fuqi të plota vetoje mbi legjislaturën dhe fuqi mandatore për të verifikuar që e tërë kushtetuta të hartohet brenda parimeve të Islamit. Në Këshillin e Mbikëqyrësve gjashtë teologë u caktuan nga Ajetullah Khomeini dhe gjashtë nga Kuvendi. Presidenti i Gjykatës së Lartë duhej të ishte gjithashtu edhe 'teolog i drejtë'. Byrokracia e stërmadhe e ngarkuar

me kontrolle dhe balancime ishte gjithashtu, në çdo detaj, krejtësisht islamike. Kreu 1 i Kushtetutës pohonte se qeverisja mbështetej mbi besimin në një Zot dhe se “njeriu duhet t’i bindet Vullnetit të Tij.” Karta e të Drejtave ishte bujare në liri individe përveç faktit se të gjitha veprimet që quheshin antiislame ndaloheshin automatikisht. Pikëpamjet e Imamit mbi kombin iranian ishin të shkruara qartë në Kushtetutë: “Të gjithë muslimanët duhet të konsiderohen si një komb i vetëm dhe Republika Islamike e Iranit do ta ndërtojë politikën e saj mbështetur mbi koalicionin dhe unitetin e popujve muslimanë dhe do të bëjë pareshtur çdo përpjekje për të realizuar bashkimin politik, ekonomik dhe kulturor të botës së Islamit.”⁷

Mirëpo çështja më e rëndësishme dhe kontroverse ishte autoriteti përfundimtar. Udhëheqja e vërtetë iu kalua një Fekihu (juristi suprem). Në të vërtetë, Fekihu ishte i plotfuqishëm. Fuqia e tij emëruese shtrihej mbi gjykatën, ushtrinë dhe Këshillin e Mbikëqyrësve. Ai gjithashtu kishte fuqi vetoje *de facto* mbi kandidatët që konkurronin thuajse për çdo post dhe të drejtën për të pushuar Presidentin. Ai mbante titullin Kryeprijës dhe ndryshe nga degë të tjera të qeverisë, mandati i Fekihut ishte i pakufizuar.⁸

Koncepti i Ajetullah Khomeinit për Fekihun u ndikua nga besimi i tij fetar i Islamit shi‘it. Shi‘izmi është distancuar gjithmonë nga shteti konvencional. Në mungesë të Imamit të dymbëdhjetë, besimi nuk kërkonte ndonjë alternativë të kualifikuar për ta udhëhequr bashkësinë në mënyrë të pavarur nga qeveria. Ajetullah Khomeini e përktheu këtë rol tek udhëheqja e shtetit. Ai e përshtati konceptin e *vilajat-i fekih*, për një sistem të udhëhequr nga më të kualifikuarit dhe më të njohurit me Ligjin islam.⁹ Kushtetuta më në fund u votua me mbështetje të jashtëzakonshme nga iranianët duke marrë miratimin e 99.5 % të votuesve. Kjo i dha Fekihut jurisdiksion jo vetëm mbi institucionet fetare dhe interpretimet e doktrinës fetare, por edhe mbi veprimet qeverisëse të ndërmarrë nga ekzekutivi, legjislativi dhe gjykata.

Një nga aspektet më interesante të zgjedhjes së Presidentit në Janar 1980, që pasoi përvetësimin e Kushtetutës, ishte deklarata e Ajetullah Khomeinit se asnjë *mullah* nuk mund të konkurronte për postin e presidentit. Kjo ishte një provë që vërtetonte faktin se edhe pse Ajetullah Khomeini bëri që Irani të qeverisej mbi bazën e orientimit dhe ideologjisë islame, ai lejonte joklerikët të dilnin në qeverisjen e Iranit përbrenda lirisë së dhënë nga Islami dhe nën drejtimin e Fekihut dhe Këshillit të tij të Mbikëqyrësve. Ebul Hasan Bani Sadr, një ekonomist dhe revolucionar i arsimuar në Francë, u zgjodh në postin e Presidentit. Ai e pranoi se Ajetullah Khomeini ishte Udhëheqësi Suprem (Fekih).

Duke treguar besim në vetëvete, Ajetullah Khomeini madje i dha postin e Kryeprijësit Bani Sadrit, por Bani Sadri ra në kundërshtim me Partinë Republikane Islamike, mbështetësen organizative të Ajetullah Khomeinit. Ai madje u përpoq të ngrinte pozicionin e tij duke shfrytëzuar luftën (me Irakun) dhe të zvogëlonte ndikimin e Ajetullah Khomeinit, duke ndërmarrë masa shtypëse ndaj mullahëve dhe Mbikëqyrësve të Revolucionit. Si rrjedhim, Ajetullah Khomeini e hoqi Bani Sadrin nga titulli i Kryeprijësit. Kjo solli një konflikt të mprehtë mes mbështetësve të Bani Sadrit dhe atyre të Ajetullah Khomeinit, duke shpjer përfundimisht në pushimin e Bani Sadrit. Presidenti i ardhshëm ishte Raxha‘i. Sulmi kundër Mbikëqyrësve të Revolucionit nga

Muxhahedinët dhe të tjerët vazhdoi. Më 2 Tetor 1981, u mbajtën zgjedhje të reja presidenciale. Kësaj rradhe Ali Khamenei, ish studiues fetar, u bë president duke fituar zgjedhjet. Ajo që e bëri zgjedhjen e Ali Khameneit edhe më të rëndësishme se dy zgjedhjet e para, ishte se ai qe mullahi i parë që fitonte vendin e presidentit. Kjo përfaqësoi një prirje të re. Ky veprim sugjeroi se vetëm një teokraci e zhvilluar plotësisht do të siguronte përmbushjen e ëndrrës së tij. Klerikët radikalë që ishin besnikë ndaj Ajetullah Khomeinit kishin marrë kontroll *de facto* të të gjitha institucioneve të shtetit pas pushimit së Bani Sadrit. Por zgjedhja e Ali Khameneit donte të thoshte se tani ata udhëhiqnin të katër degët e qeverisjes.

Vendi po përballej me luftën me Irakun. Nga njëra anë, lufta me Irakun dhe veprimtaritë e Muxhahedinëve kishin krijuar panik në qarqet qeveritare. Nga ana tjetër, u zbulua një komplot për vrasjen e Ajetullah Khomeinit. Kotebzadeh, ish-ministër i kabinetit të Bani Sadrit (dhe gjithashtu pro-amerikan) akuzohej me komplotin e vrasjes, që implikonte një nga gjashtë ajetollahët e mëdhenj të Iranit, Kazem Shariatmaderiun, i cili nuk e përkrahte konceptin e Juristit Suprem (*Fekih*). Ç'është e vërteta, ai dallonte nga Ajetullah Khomeini në disa çështje. Ai kishte bazën e tij të pavarur dhe të fuqishme të mbështetësve në Azerbaixhan. Përveç kësaj, Irani tanimë ishte zhytur në probleme të shumta. Partia Komuniste Tudeh po krijonte probleme për Republikën Islamike dhe teokracinë. Muxhahedinët i kishin shtuar sulmet e tyre. Kurdët po kërkonin autonomi dhe lufta me Irakun si dhe kriza ekonomike tashmë e kishte vendosur qeverinë nën një trysni të rëndë.

Qeveria pro Ajetullah Khomeinit e Iranit u tregua e ashpër me kundërshtarët. Siç u përmend më lart, Shariatmaderiu u përmend nga Kotebzadehu. U morën masa të rrepta kundër anëtarëve të Partisë Tudeh të cilat zgjatën deri në vjeshtën e vitit 1988. Nxjerrja e kësaj partie si e pafajshme nevojitej për të shmangur gjakderdhjen. E mbështetur nga populli, Republika Islamike filloi të funksiononte sipas referendumit për mirëqenien e njerëzve dhe sipas normave islame.

Uniteti dhe integriteti i Iranit dhe i muslimanëve iranianë u arrit dhe Irani doli si një komb i vetëm i Republikës Islamike, por me koston e humbjeve të mëdha në jetë njerëzish për shkak të rolit të Shahut dhe të SAVAK-ut të tij. Mirëpo, Ajetullah Khomeini ishte shumë i shqetësuar nga vrasjet në Iran. Ai nxori një verdikt në tetë pika që shërbeu, në të vërtetë, si karta e re e të drejtave. Ndër klauzolat më të rëndësishme të tij ishin: Nuk mund të kryhej asnjë arrestim apo konfiskim prone pa urdhër nga gjykata. Nuk mund të hyhej në asnjë shtëpi pa lejen e pronarit të saj e as nuk mund të kryheshin 'veprime jonjerëzore' mbi qytetarët. Përgjimi i telefonave apo spiunimi i qytetarëve ndaloheshin, madje edhe kur kishin për qëllim zbulimin e një krimi ose të një shkeljeje të ligjit islam. Gjithashtu, çdo veprim gjykues duhej të merrej në një mënyrë që garantonte se njerëzit ndiheshin se "jeta, prona dhe dinjiteti i tyre janë të sigurtë."

Kjo përkoi më suksesin e Iranin në shporrjen e Irakut nga thujtja të gjitha territoret e Iranit. Pozita e Ajetullahut u siguroa dhe kërcënimi ndaj Republikës Islamike, hëpërhë, mori fund. Nëpërmjet këtij verdikti në tetë pika Ajetullah Khomeini u përpoq t'i jepte Iranit një pamje më të mirë në qarqet ndërkombëtare. Qeveria iu përgjigj menjëherë Deklaratës së tij në tetë pika për të drejtat e individit nga dhjetori i vitit 1982. Vizat e daljes të kërkuara për udhëtim jashtë shtetit, të cilat deri atëherë

kishin qenë të shtrënguara, iu dhanë dhjetëra mijëra iranianëve. Universitetet filluan t'ia përshtasnin programet parimeve islame. U nis gjithashtu një fushatë për t'i bindur profesionistët iranianë, veçanërisht doktorët, inxhinierët dhe akademikët që jetonin jashtë shtetit, të ktheheshin në Iran, atdheun e tyre. Më 1984, Ajetullah Khomeini u shpreh se nuk duhej mëshuar “tepër” dhe duhej “përmbajtur nga ekstremizmi”.

Zgjedhjet për Kuvend në pranverë e vitit 1984, të dytat që nga Revolucioni, shkuan gjithashtu në mënyrë relativisht të lëmuar, pa dhunë. Kontrolli i fortë i mbështetësve të Ajetullah Khomeinit mbi aparatit e Shtetit ishte i dukshëm në ndalimin formal të grupeve kundërshtarë të dhunshme si Muxhahedin-i Khalk dhe Partia Tudeh. Në protestë ndaj mungesës së lirive demokratike, ish kryeministri Bazargan, i cili kishte patur një vend në Kuvendin e parë, dhe Lëvizja për Liri e tij vendosën të mos dilnin më në zgjedhje. Mirëpo, Partia Republikane Islamike ndjehej mjaft e sigurtë për të inkurajuar shumë joklerikë, përfshi gratë, për të kundërshtuar zgjedhjet. Kjo përbënte një ndër hapat e shumtë pozitive që implementuan dëshirën e Ajetullah Khomeinit i cili i kërkoi qeverisë të rivendoste të drejtat e burrave dhe grave, por sigurisht me parametrat e Islamit.

(c) Zgjidhja e Konfliktit mes Elitës Drejtuese

Ishte këshilla dhe konsulenca e Imam Khomeinit ajo që i zgjidhte konfliktet në shumicën e rasteve. Ndonëse joklerik, Musavi u shpall “besnik dhe i devotshëm” nga Ajetullah Khomeini. Ishte pikërisht këshilla dhe thirrja e tij për bashkim mes zyrtarëve qeveritarë që u prit mirë. Kjo vërteton se Ajetullah Khomeini nuk ishte kundër joklerikëve në poste qeveritare. Ai kërkonte unitetin e tërë iranianëve, mullahë e jomullahë, në qeverisje, me kusht që të mbeteshin besnikë ndaj Islamit. Ishte falë këshillimit dhe zgjidhjes së konflikteve nga Fekihu, Ajetullah Khomeini, që Irani plotësoi një dhjetëvjeçar revolucion deri në vdekjen e tij, pa konflikte madhore të brendshme të elitës dhe kriza institucionesh. Ai ia doli me urti çështjeve të ndryshme dhe i zgjidhi ato mes Kuvendit të orientuar drejt reformës dhe Këshillit të Mbikëqyrësve. Ky ishte një rol të cilin vetëm Ajetullah Khomeini mund ta luante asokohe.

(d) Islamizimi i Ekonomisë

Irani u përball me kriza të rënda ekonomike pas revolucionit. Konfliktet politike, lufta me Irakun, lëkundjet e shpeshta në tregun ndërkombëtar të naftës dhe ikja e kapitalistëve, kishin krijuar krizën. Qeverisë së përkohshme të Bazarganiut, pas Revolucionit, iu desh të nacionalizonte bankat dhe nismat e mëdha prodhuese, çka ishte e pashmangshme sepse ato ishin kryesisht të bankrotuara dhe të braktisura nga pronarët dhe menaxherët e tyre, të cilët mërguan nga vendi. Gjykatat Revolucionare Islamike e shpronësuan pasurinë e atyre që konsideroheshin ‘të korruptuarit mbi tokë’. Kësisoj, shumë ndërmarrje holding jobankare joindustriale, duke përfshirë shërbimet dhe pronat e patundshme, u shpronësuan brenda rregullave.

Ajetullah Khomeini filloi islamizimin e ekonomisë për zgjidhjen e problemeve të ekonomisë dhe rindërtimin e saj. Në Republikën Islamike të vendosur nga Ajetullah Khomeini, të gjitha ligjet dhe politikat ekonomike duheshin trajtuar në përputhje me ligjet islame. Dega e katërt e qeverisjes, Këshilli i Mbikqyrësve, u krijua nga Kushtetuta e re për të gjykuar ligjet shtetërore mbi bazën e normave islame. Kushtetuta e Republikës Islamike përkufizoi ekonominë. Ajo do të përbëhej nga sektorët shtetërorë, të përbashkët dhe privatë. Sektori shtetëror përfshinte të gjitha industritë në shkallë të gjerë, tregtinë e jashtme, burimet madhore minerale, bankat, sigurimet shoqërore dhe energjetikën. Sipas Kushtetutës, shtrirja e sektori privat kufizohej në ato aktivitete që ‘plotësojnë veprimtaritë ekonomike të sektorit shtetëror dhe atij të përbashkët’. Prona private e arritur në mënyrë të ligjshme duhej respektuar. Pasurisë mund t’i viheshin kufi mbështetur në legjitimitetin e burimeve të saj. Kushtetuta deklaronte se fajdja, mitoja, vjedhja dhe burimet e paligjshme, uzurpimi dhe keqpërdorimi i vakfeve, ishin burime të paligjshme prone.¹⁰

Çdo ligj i kaluar në Kuvend duhet miratuar nga Këshilli i Mbikëqyrësve për të verifikuar përputhshmërinë me ligjet islame (dhe Kushtetutën) përpara se të bëhej ligj. Vetëm Ajetullah Khomeini - Fekihu ose Juristi Suprem, kishte pushtetin për të gjykuar lidhur me vendimet e Këshillit të Mbikëqyrësve. Meqë pjesëtarët e Këshillit të Mbikëqyrësve ishin juristë dhe teologë të sprovuar islamë dhe të emëruar nga vetë Ajetullah Khomeini, ai rrallëherë e përdori veton e tij kundër gjykimit të tyre. Në vitet 1980, Kuvendi kaloi një sërë ligjesh kontroversë mbi çështje ekonomike dhe Këshilli i Mbikëqyrësve i kundërshtoi me ngulm ato si joislame.

Konflikti doli në sipërfaqe në gusht 1981, kur Kuvendi kaloi një ligj që nacionalizonte Mewatin dhe tokën urbane ‘bajer’,¹¹ për t’u siguruar strehim të varfërve. Ligji e kufizonte sipërfaqen e tokës urbane të lirë që asnjëri nuk mund ta mbante dhe e shfuqizoi pronësinë e tokave ‘të tepërta’. Ndërkohë që Këshilli i Mbikëqyrësve e kundërshtoi ligjin si joislam, kryetari atëhershëm i Kuvendit, Hashemi Rafsanxhani së bashku me një numër të madh deputetësh, i bënë thirrje Ajetullah Khomeinit, i cili iu drejtua parimit të ‘gjykimit dytësor’ (*ahkam-e awalijeh*) nën kushte ‘urgjence’ (*zororat*) dhe i dha Kuvendit autoritetin për të vendosur urgjencën e çështjeve: Kuvendi mori fuqinë për t’i kaluar këto ligje, nëse kalimi i tyre ishte i nevojshëm për ruajtjen e shoqërisë muslimane. Kuvendi deklaroi ‘urgjencën’ dhe ia kaloi ligjin Këshillit të Mbikëqyrësve, që e miratoi atë në Mars 1982, nën parimin e ‘gjykimit dytësor’; por vetëm pas pesë vjetësh dhe me kushtin që Shteti duhet të kompensonte pronarët e tokave ‘bajer’ dhe ‘dajer’. Mirëpo, Këshilli i Mbikëqyrësve, refuzoi të miratonte disa versione të ligjit që lidhej me rishpërndarjen e tokës bujqësore (madje edhe nën ‘gjykim dytësor’) dhe nacionalizimin e tregtisë së jashtme. Ai refuzoi gjithashtu të miratonte ligjin e punës dhe tejjzgatjen e ligjit për tokën urbane.¹²

Megjithatë, Ajetullah Khomeini, i cili i kishte mbështetur gjithmonë të drejtat e vërteta të punëtorëve dhe mirëqenien e tyre, e autorizoi ekzekutivin në Dhjetor 1987 që të reduktonte përfitimet e bizneseve që nuk paguanin rroga minimale, që nuk siguronin kontribute të mirëqenies, ose nuk respektonin kushtet e ligjeve që i mbronin punëtorët në përgjithësi. Këshilli i mbikëqyrësve kishte vënë veton mbi kushtetutën lidhur me reformën e tokës dhe nacionalizimin e tregtisë të miratuar nga kuvendi me shpjegimin se ato interferonin me të drejtat e pronës dhe lirinë e tregtisë, ose sepse Sheriati nuk e

përmendte këtë çështje. Drejtimi i Ajetullah Khomeinit u dha për të ristrukturuar ekonominë dhe për të ndihmuar punëtorët, gjë që ishte jetike për dhënien fund krizës ekonomike.

(e) Kombësitë dhe Etnitë

Irani ka një popullsi të larmishme në lidhje me përbërësit kombëtarë, etnikë, gjuhësorë dhe fetarë. Afro 50% e popullsisë është persiane, dhe ajo popullon pjesët qendrore të Iranit sidomos provincat e Teheranit, Isfahanit, Farsit dhe shumicën e Khorasanit. Pjesa tjetër janë turq dhe azerë (24%), kurdë (9%), arabë (2.5%), balukë dhe turkmenë (1.5%), të cilët jetojnë në territoret e tyre të vjetra në rajonet veriore, jugore dhe verilindore. Popuj të tjerë etnikë përfshijnë armenët, asirianët dhe çifutët të cilat janë të përhapur në tërë vendin. Ata dallojnë prej popujve të tjerë jopersianë nga mungesa e tokave të trashëguara.

Ajetullah Khomeini i konsideronte kategoritë 'kombësi' dhe 'etni' si armiq të Islamit dhe produkte të kolonializmit i cili sajoi metoda për të shkatërruar Islamin dhe sundimin e tij. Ai debatonte se Islami ishte superior ndaj kombësive si në teori, ashtu edhe në praktikë. Ai mendonte se Islami eliminon pabarazitë racore dhe etnike dhe i trajton njëlloj të gjitha qeniet njerëzore.¹³ Shumë shpejt pas revolucionit, filloi lufta Irak-Iran e cila e sfidoi sistemin e vjetër të të qenit të dominuar dhe të shfrytëzuar. Gjatë kësaj luftime të gjatë dhe shkatërrimtare, veprimet ushtarake në Kurdistan vazhduan pareshtur dhe në fund të vitit 1984 Republika Islamike e Ajetullah Khomeinit e fitoi luftën. Mirëpo, para operacionit ushtarak, Ajetullah Khomeini vërtet u përpoq për zgjidhje paqësore dhe pranim të pozitës së vendosur nëpërmjet bisedimeve në Kurdistan.

(f) Vetëmbështetja kundër Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik:

Ajetullah Khomeini kërkonte ta bënte Republikën Islamike të Iranit një komb të mbështetur në vetëvete dhe të pafrikësuar në skenën ndërkombëtare. Pas rrëzimit të monarkisë së Shahut të mbështetur nga Amerika, prej revolucionarëve të udhëhequr nga Ajetullah Khomeini, Amerika u armiqësua shumë ndaj tij. Sulmi mbi Ambasadën Amerikane nga disa revolucionarë më 1979, marrja e amerikanëve si pengje dhe vendimi i Ajetullah Khomeinit për vendosjen e Reppulikës Islamike dhe të vetëmbështetjes, shkaktoi armiqësi dhe sulme të mëdha të Amerikës kundër Iranit në fazën pasrevolucionare. Amerikanët filluan diplomacinë e thyerjes së krahut dhe ndërmorën masa detyruese përfshi sanksionet ekonomike kundër Republikës Islamike të Iranit. Ajo ndihmonte dhe nxiste shtetet arabe kundër Iranit. Amerika kishte angazhuar forca të jashtëzakonshme në bazat e zonave fqinje përfshi detin arabik dhe Diego Garsia. Edhe prania detare e Amerikës ishte e dukshme në Gji. Ajetullah Khomeini, që ishte Juristi Suprem (*Fekih*) si dhe Udhëheqësi (ndonëse për një kohë të shkurtër ai ia delegoi fuqinë Bani Sadrit dhe pastaj Rafsanxhaniut), e përballoi me guxim mësymjen amerikane dhe nuk u përul.

Ajetullah Khomeini ishte gjithashtu kundër politikave agresive dhe imperializmit të Bashkimit Sovjetik (sovjetikët pushtuan Afganistanin më 1979). Ai nuk e shihte Bashkimin Sovjetik si armik më të vogël se Shtetet e Bashkuara. Gjatë luftës Irak-Iran Bashkimi Sovjetik i shiste armë haptasi Irakut kundër Iranit. Në një verdikt në nëntë pika, që theksonte përparësitë e rindërtimit pas përfundimit të luftës Iran-Irak, ai i qortoi qartë teokratët kur disa nga elita shprehën idenë e normalizimit të marrëdhënieve me Amerikën dhe Bashkimin Sovjetik. Ai tha:

Së fundmi, duart e hapura dhe të fshehura lindore e perëndimore po përdorin hile të reja për të shkaktuar përçarje dhe dallime mes mbështetësve të Revolucionit Islamik. Ata janë përpjekur të shtyjnë disa zyrtarë të lartë të dashur të vendit tonë, disa figura të caktuara të Kuvendit, qeverisë dhe të fesë, që të mendojnë dhe të veprojnë në mënyra që anojnë drejt varësisë, që të shmangen nga qëndrimet e mëparshme, dhe në fund të anojnë drejt Lindjes ose Perëndimit ... Është detyrë fetare për të gjithë ju që të përpiqeni të fshini gjurmët e fundit të varësisë së këtij vendi nga të huajt ... Jam i bindur se populli iranian, veçanërisht rinia jonë do të mbajnë të gjallë në zemrat e tyre zemërimin dhe urrejtjen për Bashkimin Sovjetik kriminel dhe Shtetet e Bashkuara luftëndjellëse. Kjo duhet të jetë kështu gjersa flamuri i Islamit të valëvitet në çdo shtëpi të botës.¹⁴

(g) Politika e Jashtme dhe Diplomacia

Ajetullah Khomeini i mësoi botës një politikë të re ndërkombëtare dhe diplomaci të mbështetur në besimin e tij të thellë në fe dhe nevojën e çlirimit të vendit të tij nga kthetrat e imperializmit perëndimor, Amerikës e madje edhe Bashkimit Sovjetik. Ndaj Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, Ajetullah Khomeini zbatoi një politikë urrejtjeje kundër vendimeve të tyre të diskutueshme, jobashkëpunimi dhe konflikti të hapur për vetëmbështetje. Kjo politikë e Ajetullah Khomeinit ishte revolucionare sepse vendet e botës ishin të ndara në bllokun perëndimor dhe atë lindor të udhëhequra përkatësisht nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik, dhe ishin bërë shumë të varura nga njëra prej këtyre fuqive. Asnjë shtet nuk i kishte sfiduar të dyja superfuqitë njëkohësisht.

Agresioni i Irakut menjëherë pas Revolucionit, ishte një tjetër zhvillim i pafat për Ajetullah Khomeini dhe ishte bërë provë për aftësitë e tija për ta udhëhequr kombin në këto tetë vite të rënda (1980-88) të luftës. Besohej gjithashtu se Iraku kishte armatim më superior. Ajetullahi ia ngriti popullit të tij moralin dhe vetëbesimin nëpërmjet lidërshiptit të tij. Ai deklaroi se:

Fitorja nuk arrihet me shpata; por vetëm me gjak. Fitorja nuk arrihet me popullatë të madhe, por me forcën e besimit.¹⁵

Ajetullah Khomeini madje i bëri thirrje shumicës shi'ite në Irak t'i shpallte xhihad Partisë Socialiste Bath dhe udhëheqësit të saj Saddam Husein. Pikërisht nën drejtimin e tij, në Maj 1982, Irani më në fund e kishte kthyer luftën në favor të vet dhe kishte rimarrë territore të mëdha dhe Iraku po humbiste terren. Ajetullah Khomeini po e

kontrollonte luftën drejtpërsëdrejti. Megjithëse lufta zgjati deri më 1988, ajo peshoi më shumë në favor të Iranit.

Ishte politika e Ajetullah Khomeinit për eksportimin e revolucionit islamik, ajo që solli kryengritje në vendet fqinje arabe duke qenë se shumica prej tyre ishin nën sundimin monarkist. Ai deklaroi:

Ne do t'ia eksportojmë revolucionin tërë botës, gjersa thirrja 'nuk ka zot përveç Zotit' të kumbojë në çdo vend. Do të ketë përplasje.¹⁶

Ndihma ushtarake e Iranit në Liban në mbështetje të OÇP kundër agresionit izraelit më 1982, shënoi fillimin e fushtaës së jashtme të Iranit, në konfliktin arabo-izraelit. Më përpara, Shahu i Iranit kishte qenë pak më shumë se vëzhgues i distancuar i katër luftërave të tjera arabo-izraelite që më 1948. Shahu madje i kishte shitur (e dhuruar) naftë Izraelit duke shpërfilluar OPEK-un dhe kishte mbajtur marrëdhënie diplomatike me të. Në kontrast me Shahun, Ajetullah Khomeini synoi paseshtur të luante rol aktiv në konfliktin e pestë. Në ndryshim nga bota arabe, që tregonte ankth dhe zemërim, Ajetullah Khomeini dërgoi Pasdaranin për t'i ofruar mbështetje konkrete OÇL-së.

Frika nga Ajetullah Khomeini në vendet arabe ishte e atillë që gadishulli arabik në fund formoi Këshillin e Bashkëpunimit të Gjirit, një aleancë e gjashtë vendeve më të fuqishme dhe të pasura mbretërore për t'i bashkuar burimet e tyre ushtarake.

Ajetullah Khomeini, për sa kohë ishte gjallë, nuk lejoi devijime dhe shtrembërime të pastërtisë dhe qëllimit të Revolucionit. Shpeshherë, veçanërisht gjatë ditëve të fundit, disa persona u përpoqën të përvetësonin qëndrim të moderuar për zgjidhjen e debateve të vjetra, por Ajetullah Khomeini nuk i lejoi ata të devijonin nga premiset themelore. Ai paralajmëroi:

Për sa të jem gjallë, nuk do të lejoj që revolucioni ose regjimi të devijojë nga udha e shtruar për të.¹⁷

Çështja e librit 'Vargjet Satanike' të Salman Rushdiut, e cila i bënte një trajtim satirik dhe përdhosës figurës së Profetit Muhamed (pqmt) dhe figurave të tjera të shenjta të Islamit shkaktoi protestë dhe zemërim publik në Shkurt 1989, në shumë vende të Evropës, Afrikës dhe Azisë përfshi Indinë. Përsëri, askush përveç Ajetullah Khomeinit nuk dha verdiktin e dënimit me vdekje për Salman Rushdiun. Fetvaja e Ajetullah Khomeinit e bëri qeverinë e Iranit të përvetësonte një politikë zyrtare kundër librit, autorit dhe mbështetësve të tij. Anëtarët e Bashkimit Evropian u përgjigjën duke e dënuar njëzëri Ajetullah Khomeinin për verdiktin e tij dhe më pas, individualisht, duke i tërhequr ambasadorët e tyre. Por ai nuk ndryshoi qëndrim. Ai këshillonte:

Për sa kohë që të jem gjallë nuk do të lejoj që qeveria të bjerë në duart e liberalëve. As sanksionet e ripërtëritura ekonomike nuk mund të na "detyrojnë të tërhiqemi dhe të kapërcejmë vendimin e Zotit."¹⁸

Ajetullah Khomeini kishte bindjen e fortë se kombit nuk duhet t'i mungojë besimi. Kjo nuk vlente vetëm për Iranin por edhe për të tjerët, dhe ja përse ai i shkroi Presidentit Gorbaçov të Bashkimit Sovjetik, duke i sugjeruar që Moska të ndërmarrë një studim të Islamit, sepse besimi “mund të zgjidhë nyjet e problemeve themelore të njerëzimit dhe të mbushë lehtë zbrazëtinë ideologjike të sistemit tuaj.”

Në sajë të ndikimit të tij mbi Iranin, Lindjen e Mesme dhe mbarë botën, Ajetullah Khomeini ishte, padyshim, një udhëheqës dhe ndërtues kombi shumë i madh. Sikurse tërë udhëheqësit e mëdhenj të botës, stili dhe sjellja e tij kishin qenë unike dhe krejtësisht të ndryshme nga ato të të tjerëve. Kombi i Republikës Islamike të Iranit, të cilin ai e ndërtoi, i mbijetoi një lufte që zgjati pothuajse sa dy Luftërat Botërore së bashku. Ai u përball me kriza ekonomike, sanksione, izolim diplomatik, armiqësi të të dyja superfuqive të atëhershme (SHBA dhe BS) njëkohësisht, armiqësi të vendeve fqinje arabe dhe ndarjet e brendshme; e prapëseprapë ai doli ngadhënjyes. Ndiheza kryesore e Ajetullah Khomeinit pas rrëzimit të Shahut, në të vërtetë, ishte ndërtimi i kombit të Iranit për një dhjetëvjeçar të plotë duke e lejuar kështu revolucionin të lëshonte rrënjë dhe klerin të merrte përvojë në qeverisjen e shtetit. Duke kombinuar fenë dhe politikën ai e ristrukturoi aparatit e brendshëm politik duke përhapur pushtetin përtej elitës së pasur të vesternizuar të regjimit të Shahut. Ai gjithashtu ia doli të trazonte barazpeshën rajonale dhe ndërkombëtare të fuqisë, duke i detyruar superfuqitë ta merrnin si Iranin, ashtu edhe Islamin, seriozisht. Ai u mësoi superfuqive se ndërhyrja ushtarake dhe detyrimi politik nuk mund ta gjunjëzojnë një komb të vendosur të botës së tretë që ka besim në Allahun. Forca e tij kryesore ishte besimi, Islami, që iu mësua në vend një brezi të tërë të ri si mënyrë jetese dhe mjet qeverisjeje, dhe botës së jashtme iu bë e ditur se feja mund të ishte një forcë e fuqishme në ndërtimin e një kombi. Në procesin e ndërtimit të kombit në Iran, Ajetullah Khomeini ishte kritikuar nga media perëndimore. Ai dhe Irani u përball me qëndresë të fortë kundër vendosjes së vlerave islame. Por, i patrembur nga një lëvizje e tillë, ai ia doli në ndërtimin e kombit iranian mbi një besim të fortë.

Referenca:

1. *International Herald Tribune*, 6 Shkurt 1979.
2. Saul Bakhsh, *The Reign of Ayatollahs: Iran and the Islamic Revolution*, f. 16; John Simpson, *Inside Iran: Life Under Khomeini's Regime*, ff. 47-49; Mohsen M. Milani, *The Making of Iran's Islamic Revolution: From Monarchy to Islamic Republic*, ff. 88-9.
3. *International Herald Tribune*, 7 Shkurt 1979.
4. po ajo, 15 Mars 1979.
5. *Time*, 26 Janar 1979, f. 14.
6. *Canberra Time*, 12 Mars 1979.
7. Kushtetuta Iraniane.
8. Në kontrast, mandati presidencial u kufizua në një maksimum prej 4 vitesh; anëtarët e kuvendit njëdhomësh në një numër të pakufizuar në një mandat prej 4 vjetësh, Këshilli i Lartë Gjykues në 4 vjet dhe Këshilli i Mbikëqyrësve në 6 vjet.
9. Cheryl Benard & Zalmay Khalilzad, *The Government of God: Iran's Islamic Republic*, f. 111.
10. Kushtetuta e Republikës Islamike të Iranit, përk. Hamid Algar (Berkeley: Mizan Press, 1980), ff. 46-7.
11. *Mewat* do të thotë i pareklamuar, *bajer* do të thotë i reklamuar dhe i papërdorur, dhe *dajer* do të thotë i reklamuar dhe në përdorim.
12. Vendimet e Këshillit të Mbikëqyrësve janë përmbledhur në Madani, *Hukuk-e Asasi*, vëll. 4, ff. 177-457, dhe vëll. 7, fq 211-82.
13. Pikëpamjet e Khomeinit mbi nacionalizmin citohen në *Xhostoxhu-je Rah az Kalan-e Imam (Defter-e Jazadahum)*, Meligara'i (Tehran: Amir Kabir, 1983).
14. "Letra e Khomeinit mbi Udhëzimet për Rindërtim", nga Radio Tehrani, në Shërbimin e Informacionit për Transmetim të Jashtëm, 4 Tetor 1988, ff. 46-8; *Soheher-azade Daneshku ans Dafa Haeri*, "Restoring Relations", *Middle East International*, 7 Tetor 1988, ff. 11-12.
15. Radio Tehrani, cit. në Shërbimin e Informacionit për Transmetim të Jashtëm, 10 Mars 1982.
16. Ayatollah Khomeini, "Excerpts from Speeches and Messages of Imam Khomeini on the Unity of the Muslims", i shpërndarë nga Ministria e Udhëzimit Islam, Tehran, Republika Islamike e Iranit.
17. shih 14.
18. "Khomeini puts Iran on Renewed Hard-line Policy over Rushdie", Reuters, 23 Shkurt 1989.

Mendime të Ajetullah Khomeinit mbi *Vilajet-i Fekih*

Naushen Xhaferi, Studiues kërkimor, Departamenti i Historisë dhe i Kulturës, Xhamie Milie Islamie, Nju Delhi

Kundërvënia e papajtueshme e Ajetullah Ruhullah Imam Khomeinit ndaj regjimit të Pahlaviut dhe koncepti i tij themelor revolucionar i Shtetit Islam u shprehën në një sërë leksionesh që ai u dha studentëve të tij në Nexhef të Irakut, rreth vitit 1969. Këto ligjërata u botuan në një libër me titull *Vilajet-i Fekih*.¹ Ky term nënkupton kujdestarinë qeverisëse të juristëve islamë, që janë njerëz të thelluar në Ligjin islam. *Vilajet-i Fekih* artikulon idetë thelbësore të Ajetullah Khomeinit për shtetin si dhe qëllimet që ky do të ndiqte në dhjetëvjeçarën e ardhshme. Ai ishte projekt-plani për riorganizimin e shoqërisë dhe një doracak revolucionar.²

Katër Temat Kryesore që Dalin nga Libri:

Së pari, ai përfshin një kundërshtim të institucionit të monarkisë, si i huaj për Islam, i urryer nga Profeti (pqmt) dhe si burimi i të gjitha fatkeqësive të Iranit për më shumë se 2500 vjet histori.

Së dyti, ai e paraqet Shtetin Islam, të mbështetur në Kur'an dhe të modeluar sipas bashkësisë islame të qeverisur nga Profeti (pqmt) në shekullin e shtatë, jo si një ideal të arritshëm vetëm në një të ardhme të largët, por si një formë praktike qeverisjeje e realizuar në kohën e brezit të sotëm.

Së treti, ai është një afirmim i fuqishëm i pohimit të dijetarëve fetarë, si trashëgues të pelerinës së Profetit (pqmt) në udhëheqjen e bashkësisë. Një nga dy cilësitë (drejtësia dhe njohja e Ligjit) që janë thelbësore për sunduesin ose qeverisësin, sipas *Vilajet-i Fekih*, buron nga kjo njohje e Ligjit. Ajetullah Khomeini shkruante se qeverisësit e vërtetë janë vetë juristët islamë. Pikërisht ata duhet të ushtrojnë mbikqyrje mbi të gjitha çështjet ekzekutive, administrative dhe planifikuese të vendit. Për më tepër, ndërkohë që *ulematë* (dijetarët fetarë) mund të ushtrojnë lidërsip mbi bashkësinë në mënyrë kolektive, në konsultim me njëri tjetrin, udhëheqja duhet t'i vishet një figure të vetme fetare të shquar.

Ajetullah Khomeini pohonte gjithashtu se *nëse një jurist i merituar është i dhuntisur me këto cilësi* (drejtësi dhe njohje e Ligjit islam), *atëherë kujdestaria e tij do të jetë në dritën e dijes dhe fuqisë së zotëruar nga Profeti (pqmt) në qeverisjen e bashkësisë islame, dhe kësaj është e detyrueshme që të gjithë muslimanët t'i binden atij*.

Duke e shkoqitur këtë pikë, Ajetullah Khomeini citon një *hadith* (traditë) që i mvishet kalifit Ali, i cili thuhet se tregon për lutjen e Profetit (pqmt) drejtuar Zotit për t'i bekuar ata që do të vinin pas tij. Profeti Muhamed (pqmt) kishte thënë: “O Zot, bekoji ata që do të vijnë pas meje (ai e përsëriti këtë tri herë)”. Profeti (pqmt) u pyet se kush do të ishte pasuesi i tij dhe ai u përgjigj: Ata që vijnë pas meje dhe përcjellin fjalët

dhe traditat e mia dhe ua mësojnë ato njerëzve në mungesën time.” Në një debat në nivel të lartë dituror, Ajetullah Khomeini e bën të qartë se ka për ligje ligjore dhe doktrinare për një rol aktiv nga ana e *ulemave* në ngritjen e qeverisë islame nën parimin e *Vilajet-i Fekih*.

Së fundi, *Vilajet-i Fekih* e përshkruan si të detyrueshme për të gjithë besimtarët që të punojnë në mënyrë aktive për përmbysjen e shtetit joislam: Ajetullah Khomeini shkruante: *“Nuk kemi përzgjedhje tjetër veçse të flakim qeverinë mizore, ose atë qeveri që shkakton mizori, dhe t’i rrëzojmë qeveritarët që janë tradhtarë, mizorë, të prishur dhe tiranë.”*

Librat e Ajetullah Khomeinit parashtrajnë gjithashtu hapat sipas të cilëve duhet rrëzuar regjimi i Pahlaviut. Kësisoj ato janë manuale të revolucionit - por jo revolucionit të dhunshëm. Ai i nxiste studentët fetarë dhe klerikët, mësuesit, profesorët e universitetit dhe të gjithë iranianët që të punonin për realizimin e shtetit islam duke e ngritur zërin, duke mësuar dhe duke u organizuar në mënyrë aktive, me fjalët: *“kur t’ju kundërvihen, ngrijeni zërin, protestoni dhe zbulojeni të pavërtetën.”*

Në të njëjtën kohë, ai i nxiste ndjekësit e tij ta mohonin legjitimitetin e qeverisë ekzistuese dhe të institucioneve të saj duke ua refuzuar këtyre njohjen dhe duke ua drejtuar besnikërinë e tyre institucioneve islame. Ai thonte se *njerëzit duhet t’i paraqesin paditë e tyre ligjore jo në gjykatat e shtetit por te gjyqesit e tyre islamë*. Ata nuk duhet t’i paguajnë taksa qeverisë por udhëheqësve të tyre fetarë. Shkurtimeisht, ata duhet të krijojnë një lloj qeverie paralele. Një aktivitet i tillë, i shoqëruar me opozitë të sigurtë, do ta mobilizonte gradualisht popullatën:

...Njerëzit do të zgjohen dhe do të bëhen aktivë... do të krijohet një valë dhe një lëvizje opozitare në të cilën do të marrin pjesë njerëz të përshpirtshëm dhe të ndershëm... në fund, ata do të depërtojnë si një fuqi në qeveri, ose do ta luftojnë dhe rrëzojnë atë.

Kështu, qeveria duhet të ketë si qëllim ngritjen e një shoqërie të mbështetur mbi drejtësi sipas ligjeve të Islamit. Qeveritë nuk duhet të jenë qëllim në vetëvete por, nëpërmjet implementimit të Sheriatit islam, t’u përgjigjen nevojave të njerëzve. Lidhja ndërmjet pushtetit ekonomik dhe atij politik çon shpesh në lakmi dhe korrupsion. Juristi, pra, duhet të mundësojë që pasuria të mos grumbullohet në duart e atyre që qeverisin duke i shfrytëzuar njerëzit dhe burimet e tyre për përfitimin e sundimtarit. Për ta kontrolluar këtë, zotëruesit e posteve politike duhet të bëjnë jetë të thjeshtë, si ajo e bërë nga Profeti (pqmt), kalifi Ali dhe Imamët e tjerë. Një kontroll mbi përqëndrimin e pasurisë do të kryhej përmes implementimit të sistemeve islame të taksimit. Kjo jo vetëm do ta ngushtonte hendekun ndërmjet shumë të pasurve dhe të skamurve por do të siguronte gjithashtu që pasuria të mos arrihej përmes shfrytëzimit. Juristët, me anë të kuvendit dhe gjykatës, duhet ta mbikëqyrin një punë të tillë dhe të sigurojnë që ekzekutivi e kryen ekeftivisht përgjegjësinë e vet dhe se nuk i tejkalon fuqinë e tija. Por detyra e gjykatës ishte më e rëndësishme. Është thelbësore që përgjegjësia t’u besohet juristëve, njohja e ligjit nga të cilët ishte thelbësore për të vendosur drejtësinë ndër njerëz. Roli i gjykatës shtrihej edhe në punën e legjislativit dhe të ekzekutivit.³

Kuvendi, nga ana tjetër, duhej zgjedhur nga njerëzit. Një zgjedhje e tillë duhej të ishte kushtetuese, por konotacioni i kësaj të fundit dallon nga kuptimi i saj perëndimor. Sipas Ajetullah Khomeinit: *“Nuk është kushtetuese në sensin popullor të fjalës, që nënkupton përfaqësim në sistemin parlamentar ose në këshillat popullorë. Ajo është kushtetuese në kuptimin se ata që janë të ngarkuar me autoritet u binden një sërë kushteve dhe rregullave në Kuran dhe në Sunneh (traditën profetike)... ja përse qeveria islame është qeveria e Ligjit Hyjnor.”*

Juristët dhe të tjerët që zgjidhen për në Kuvend (Mexhlis) duhet të kryejnë një funksion që menaxhon konfliktet. Aty ku dalin probleme të natyrës doktrimore, që nuk mund të zgjidhen as nga qeveria as nga Mexhlisi, përgjegjësinë islame e ka juristi. Ai *“duhet të punojë veçmasi ose në kolektiv për të ngritur një qeverisje legjitime që vendos rregull. Nëse kompetenca për këtë detyrë do të kufizohej në një person, atëherë do të ishte obligim i tij që ta bënte këtë me trup; përndryshe detyra ndahet në mënyrë të barabartë. Në rast vështirësie në formimin e asaj qeverije, [atributi] i qeverisjes nuk zhduket. Juristët duhet të veprojnë sa të munden në përputhje me detyrat që u janë ngarkuar... Paaftësia e përkohshme për të formuar një qeveri të fuqishme dhe të plotë nuk do të thotë aspak se duhet të tërhiqemi. Marrja me nevojat e myslimanëve dhe implementimi në mesin e tyre i ligjeve të mundshme për t’u implementuar është për ta detyrë aq sa të munden.”*

Për të ushtruar rolin e *Vilajet-i Fekih*, një person duhet të zotëronte njohje të thellë të Islamit dhe të ishte i drejtë. Sipas pikëpamjes së Ajetullah Khomeinit, pikërisht një person i tillë duhej vendosur në krye të qeverisjes. Ishte detyrë e tija të qeveriste siç ka urdhëruar Zoti, por qeverisja nuk përbën një qëllim në vetvete. Ajo është një mjet ... për sa kohë që synimi i saj është fisnik. Nëse ajo kërkohet si qëllim dhe nëse për ta arritur përdoren të gjitha mjetet, ajo degjeneron në nivelin e krimit. Prijësia islame e Profetit Muhamed (pqmt) dhe pasardhësve të tij ka lënë shembuj të bollshëm se si duhet kryer qeverisja islame. Duke marrë rastin e Imam Huseinit, nipit të Profetit (pqmt), Ajetullah Khomeini e nxori parimin nga tragjedia e Qerbelasë: Nëse një tiran do të sundonte në mënyrë despotike mbi muslimanët, në cilëndo epokë, duhet të ngrihem kundër tij dhe ta demaskojmë.. sado të pabarabarta të jenë forcat tona, dhe ‘nëse nevojitet, duhet të flijojmë veten dhe të jemi të gatshëm të derdhim gjakun tonë.’ Islami i ‘kundërvihet krejtësisht nocionit të monarkisë... Islami erdhi për të shkatërruar këto pallate të tiranisë’ dhe Ajetullah Khomeini tregoi se nëse duhej zgjedhur midis monarkisë dhe *Vilajet-i Fekihut*, ky i fundit duhej zgjedhur nëpërmjet mbështetjes popullore dhe revolucionit.

Ajetullah Khomeini fliste si një dijetar dhe si qytetar i Iranit. Një nga temat e vazhdueshme të të gjitha deklaratave të tij ishte se ulematë (dijetarët e fesë) kanë një rëndësi dhe dinjitet të madh në Islam, që tregohet në thënien e Profetit se ata ‘janë trashëgimtarët e profetëve’ (pqmt) dhe se ata nuk mund ta përcjellin në mënyrë efektive trashëgiminë e profetëve (pqmt) thjesht duke u tërhequr në qoshen e një medreseje dhe duke lexuar e komentuar tekstet hyjnore. Ata kanë një detyrë shumë më gjithëpërfshirëse udhërrëfimi. Ai fliste si një *alim* (i shumëditur), i ndërgjegjshëm për natyrën e gjerë të përgjegjësisë së tij. Por kjo ndryshon nga të folurit në emër të ulemave si klasë. Përkundrazi, ai iu drejtua tërësisë së kombit iranian dhe, përtej kësaj, krejt myslimanëve.

Duke filluar nga viti 1970, Ajetullah Khomeini filloi gjithashtu të shkëmbente mesazhe me shoqatat e studentëve iranianë në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara, në të cilat ai i nxiste ata t'i përkustoheshin promovimit të një qeverie islame për Iranin. Tek ai, ata panë një udhëheqës të mundshëm në kauzën e tyre të përbashkët kundër Shahut. Ata kishin kontakte me shtypin amerikan dhe evropian, me parlamentarët në organizata të ndryshme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; dhe qenë të aftë të fitonin vëmendjen ndaj shkeljeve të të drejtave njeëzore dhe aspekteve të tjera negative të regjimit të Shahut.

PËRFUNDIM

Ndonëse grupe dhe parti politike të caktuara e mbizmadhuan rolin e tyre në revolucion pas arritjes së fitores, ishte Ajetullah Khomeini ai që i drejtoi energjitë e iranianëve që t'u kundërviheshin gjithmonë tiranisë dhe shtypjes e të kërkonin rivendosjen e qeverisjes kushtetuese të një Republike Islamike.⁴ Ai kishte formuar Këshillin Revolucionar Islam. Më 1979 Muhamed Reza Shahu nuk kishte zgjidhje tjetër veçse të linte Iranin i turpëruar dhe pati gazmende në të gjithë vendin. Në periudhën pasrevolucionare Ajetullah Khomeini ushtroi *Vilajet-i Fekihun*, një figurë gjykimit të të cilit i bindeshin të gjithë. Ai qeverisi por nuk sundoi. Ai dha direktiva të përgjithshme, që u implementuan nga persona të ndryshëm që hartuan dhe ngritën strukturat e shtetit. Pushteti i tij nuk u arrit vetëm nga pozita e tij islame por edhe nga populli, që i bindej urdhërit të tij.

Shpалosja e rolit të *Vilajet-i Fekihut* u pa qartë kur Ajetullah Khomeini i dha vendime të reja gjykatës për të zbutur zellin e tepruar, kualifikimin e gjykatësve dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të të dyshuarve nga ligji islam. Për shembull, kur një gjykatës, H. I. Halkali, u bë mbientuziast për punën e tij në dhënien e dënimeve me vdekje, ai u hoq nga posti.

Sipas pikëpamjes së Ajetullah Khomeinit, vetëm një *Fekih* mund të ndërmerre veprim dhe të krijonte një sistem të volitshëm mirëqenieje për njerëzit, sepse qeveria nuk ishte monopol i një klase apo i një dinastie. Sovraniteti i takonte Zotit dhe Fekihu ishte i kualifikuar për të luftuar në emër të Islamit.

Disa thënie të urta të Ajetullah Khomeinit:⁵

- *Vilajet-i Fekih* është një dhuratë nga Zoti i Madhërishtëm për myslimanët.
- Neni më i mirë në Ligjin e Kushtetutës është neni që parashtron *Vilajet-i Fekihun*.
- Sot, juristët muslimanë janë provë (*huxhxheh*) për njerëzit.
- *Vali-je Amri* (Prijsi i Fesë) është Prova dhe Shenja e Zotit.
- Kombi që nuk ka “udhërrëfyes” nuk mund të arrijë shumë.
- E siguroj kombin dhe forcat ushtarake që nëse pushteti islam mund të implementohet nën mbikëqyrjen e *Fekihut*, atij vend nuk do t'i vijë asnjë e keqe.
- Nëse *Fekihu* ndërmerr një hap të gabuar, ose kryen mëkat të vogël, ai bie nga *Vilajeti*, dhe ky nuk mund t'i ngarkohet asnjëri.
- *Fekihu* nuk ia imponon popullit pikëpamjet e tij; nëse e bën këtë, ai e humbet *Vilajetin* e tij.
- Është *Vilajet-i Fekih* ai që zbut diktaturën, e cila zhvillohet në mungesë të tij.

Referenca:

1. *Velajat-e-Fakih: Hukumat-e-Eslami* [Kujdestaria e Juristit: Pushteti Islam], Tehran, 1357 h.s. (1978). Ky libër u shfaq në shumë botime klandestine më 1978-79 nën emrat Talikani dhe Bazargan.
2. Bakhash, Shaul, *The Reign of the Ayatollahs: Iran and the Islamic Revolution*, London, 1985, f. 38.
3. Hussain, Asaf, *Islamic Iran: Revolution and Counter Revolution*, London, 1985, f. 76.
4. Rizvi, S. A. A., Royalty, *Religion and Revolution*, Australia, 1980, f. 343.
5. Pithy Aphorisms, *Wise Sayings and Counsels: Imam Khomeini*, Tehran, 1994, f. 102-3.

Ajetullah Khomeini mbi Zhvillimin Ekonomik të Republikës Islamike të Iranit

Prof. S. M. Vvasim, Drejtues i Departamentit të Tregtisë, Koordinator i Programit DSA, dhe ish-dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti Musliman i Aligarhut, Aligarh, Indi.

Në të shkruarit për pikëpamjet ekonomike të Ajetullah Imam Khomeinit mbi zhvillimin ekonomik, është me vend të shkoqisim pak mbi Republikën Islamike dhe përgjegjësitë e saj. Duke theksuar përgjegjësitë e Republikës Islamike, Ajetullah Imam Khomeini tha: “Në një republikë islamike nuk ka shtypje. Në një republikë islamike gjendja e detyrimit nuk ekziston. Të pasurit nuk mund t’i detyrojnë njerëzit të punojnë për paga të ulëta. Këtu duhen zgjidhur dhe vënë në jetë problemet islame. Të deprivuarit duhet të fuqizohen dhe të shndërrohen. Arrogantët duhet të bëhen si të deprivuarit dhe të deprivuarit nuk duhet të ngrihen si arrogantët por përkundrazi, si vëllezër dhe të jetojnë në këtë vend së bashku.”

“U them të gjitha kombeve se në një republikë islamike nuk ka privilegje që i ndajnë të pasurit nga të varfrit, të zinj të bardhët, sunnitë nga shi‘itët, arabët, jo arabët e të tjerët nga turqit. Kurani i Shenjtë i jep përparësi drejtësisë dhe përzotshmërisë. Personi i përzotshëm ka përparësi. Përsoni që ka shpirt të mirë ka përparësi. Mirëpo këto përparësi nuk lidhen me gjërat materiale, me pronën. Nëse ekzistojnë, ato duhet të hiqen. Të gjithë njerëzit janë të barabartë me njëri tjetrin. Të gjithë kanë të drejta të barabarta. Ata janë të barabartë...”¹

Kështu, ai thekson se:

- a) askush nuk duhet lejuar të mbizotërojë të tjerët thjesht pse ka pasuri materiale
- b) privilegjet e mbështetura mbi gjërat materiale dhe pronën, duhen hequr
- c) barazia mes njerëzve duhet të jetë parimi udhëheqës, që siguron të drejta të barabarta, dhe
- d) çdo përparësi e ushtruar, duhet mbështetur mbi drejtësi dhe përzotshmëri. Kjo përputhet me normën kuranore.

Kësisoj, një shoqëri e mbështetur mbi drejtësinë dhe përzotshmërinë, do të arrijë një rend të drejtë social-ekonomik që zbaton parimin e drejtësisë pa shfrytëzim të njeriut nga njeriu. E as nuk do të ketë ‘të shfrytëzuar’ dhe ‘shfrytëzues’, ‘të kamur’ apo ‘të skamur’, dhe ‘të deprivuar’ e ‘arrogantë’. Kjo do të vërë kontroll mbi keqshpërndarjen e pasurisë, do të shmangë pabarazitë në arritjen e pasurisë dhe në mundësitë e ofruara. Përveç kësaj, kjo do të sigurojë një sistem social-ekonomik që funksionon lëmueshëm pa shfrytëzim dhe tirani.

Ajetullah Khomeini kërkonte një zhvillim të vetëmbështetur të ekonomisë së Republikës Islamike të Iranit pa u varur për këtë në ndonjë pol fuqie ose bllok. Ai kërkonte një bazë vendase të ekonomisë ku vendimet për të prodhuar, investuar dhe konsumuar merren pa kurrfarë ndikimi të jashtëm. Ai i paralajmëroi kombet e sunduara me fjalët: “Mes kompleteve të rënda, të cilat, mjerisht, kanë lënë pasoja shkatërrimtare

mbi atdheun tonë të dashur, ka qenë ai i tëhuajësimit të vendeve të kolonizuara dhe detyrimi që ato të shohin nga Perëndimi dhe Lindja për modele. Aq sa, këto vende humbën vetërespektin e tyre dhe besimin në kulturat e tyre, dhe e vështrojnë Perëndimin e Lindjen si dy polet e pushtetit që kanë qytetërim më fisnik dhe më të lartë dhe konkluduan se vendet e tyre nuk mund të bënin ndryshe veçse të vareshin prej njëres nga këto fuqi.”²

Fjalët e mësipërme ngacmuese japin një pamje më në thellësi të krejt gamës së marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare, dhe flukseve të importit dhe eksportit. Pushtimi kulturor sjell dislokim dhe shtrembërim në shumë mënyra: zgjedhja e teknologjisë, veprimet bankare, fluksi i huave ndërkombëtare, ndihmat dhe borxhet, forma e konsumit, teknikat e ndërtimit etj, ndikohen të gjitha. Zhvillohen varësi dhe kombet e varura e humbin vetërespektin e tyre. Ajetullah Khomeini pohonte: “Kjo ka qenë një histori e gjatë dhe trishtuese, dhe goditjet që marrim nga dy superfuqitë janë të rënda dhe vdekjeprurëse. Mirëpo, akoma më e trishtueshme është se këto dy superfuqi kanë kontrolluar progresin e kombeve që ato duan t’i kthejnë në vende të orientuara drejt konsumit, dhe të na kallin frikën me përparimet e tyre teknologjike dhe pushtetin e tyre satanik e të shkatërrojnë vetëbesimin tonë për të testuar intuitën tonë, në mënyrë që t’ua lëmë administrimin e Shtetit atyre fuqive.”³

Kjo situatë është fatale: ajo shkatërron vetëbesimin dhe kapacitetin për të zhvilluar teknika e teknologji. Pastaj, kombet thjesht imitojnë në vënd që të marrin nisma dhe risi, sepse “ky sens mosvlere dhe kjo ndjenjë plogështie që na futet nga fuqitë e mëdha, na bëri që të mos kemi besim në dijen, ekspertizën dhe kapacitetin tonë në të gjitha fushat dhe na çoi në imitimin e thjeshtë e të verbër të Perëndimit dhe Lindjes, nga njerëzit tanë të pakulturuar të teknologjisë dhe intuitës, aq pak sa kishim, të magjepsur nga Perëndimi dhe Lindja, që përçmonin kapacitetet tona të brendshme dhe duke propaganduar kulturën ekzotike të të huajve, edhe pse ata mund të jenë krejtësisht absurdë e qesharakë, dhe duke ua imponuar ato kultura kombeve që i admirojnë edhe sot.”⁴ Ai përfundoi duke thënë se: “për sa kohë që të jeni në këtë gjendje imitimi, mos kërkoni pavarësi. Përderisa të gjitha fjalët e shkrimtarëve tuaj janë perëndimore, mos shpresoni që kombi juaj të jetë i pavarur. Për sa kohë që rrugët tuaja të kenë këto emra dhe barnatoret, librat, parqet dhe të gjitha gjërat tuaja të mbajnë emra të huaj, nuk do të bëheni të pavarur.”⁵

Prandaj, sipas Ajetullah Khomeinit, themeluesit të Republikës Islamike të Iranit, ishte thelbësore të zhvillohej një vazë teknologjike dhe ndërmarrëse e vetëmbështetshme, që do të garantonte zhvillimin ekonomik me dinamizëm. Ai e bëri “.. detyrim mbi qeveritë dhe popujt e varur që tani dhe në të ardhmen ta çmonin ekspertizën e tyre vendase, dukei mbështetur ato me ndihmën e tyre materiale dhe inkurajimin moral.”⁶ Ndërkohë që lavdëronte përpjekjet vendase për të zhvilluar teknologji dhe ekspertizë në të gjitha fushat. Ai u caktoi atyre rolin e transferimit të teknologjisë, duke u thënë: “Mbajeni mend që edhe pse në disa fusha varësia nga një vend i huaj mund të duket krejtësisht në rregull me disa avantazhe kalimtare, në afatin e gjatë ajo do të shkaktojë shkatërrim të vendit.”⁷ Pikërisht kështu, sepse “... për sa kohë që t’i zgjasni dorën të huajve për nevojën tuaj në teknologji të përparuar dhe për sa kohë të bëni jetë lypsave në bashkësinë ndërmbarë, nuk do ta shihni zhvillimin e talentit tuaj shpikës në teknologji.”⁸ Kështu, duke mbrojtur vetëmbështetjen afatgjatë, Ajetullahu i

nderuar deklaroi: “Në vazhden e sanksioneve ekonomike ndaj Iranit ju e patë me sytë tuaj se të njëjtit iranianë që dikur e gjykonin veten si të paaftë për të bërë shumë gjëra të bëra më parë nga punonjës të huaj dhe të cilëve më parë u ishte thënë se ata nuk do të ishin në gjendje ta vinin në funksionim industrinë e vendit, duke i mosbesuar kapacitetit të tyre për ta arritur këtë, në fund guxuan të mbështeteshin në talentin e tyre dhe me këtë iu përgjigjën nevojave të forcave të armatosura dhe fabrikave e uzinave të tyre.”⁹ Megjithatë, ai shprehu mendimin e tij të barazpeshuar duke thënë: “...nevoja jonë për industrinë e përparuar të vendeve progresive është e padiskutueshme, por kjo nuk duhet interpretuar që për teknologji të avancuar dhe specializim shkencor do të na duhet të mbështetemi mbi cilindo prej dy blloqeve politike të fuqisë.”¹⁰ Ai i inkurajoi kombet e deprivuara të bashkoheshin, veçanërisht ummetin musliman, duke u thënë se ata duhet t’u “tregojnë të gjitha vendeve se Islami mbështetet mbi vëllazëri, barazi dhe unitet.” Në përputhje me këtë, ai i dha zemër popullit të vet të hiqte qafe të gjitha pabarazitë e pambështetura në parime. Kjo zbatohet njëllor mbi pabarazitë në të gjitha sferat e jetës njerëzore; qoftë kjo konsumi, tregtia apo prodhimi; qofshin të ardhurat dhe mundësitë për të ngritur pasuri apo shpërndarja e sigurisë shoqërore. Ai thonte: “Tregu ynë duhet të jetë islamik. Ai duhet të pastrohet nga të gjitha pabarazitë. Të gjitha postet qeveritare sot dhe në të ardhmen duhet të mbështeten në parime islame.”¹¹

Njëherë, një grup pronarësh fabrikash shkuan të takoheshin me Ajetullah Khomeinin i cili u kërkoi t’i ndreqnin gjërat vetë. Ai i këshilloi me fjalët: “Mbani takime, diskutoni dhe ngritni kapitalin tuaj që të ndërtoni strehim për punëtorët e këtyre fabrikave. Sigurojuni atyre jetesë më të mirë...”, “... nëse nuk e bëni këtë, mundet që, mos dhashtë Zoti, ata të rebelohen dhe nëse rebelohen ne nuk mund t’i ndalim më.”¹² Ai pra, thekson nevojat legjitime të punëtorëve, sigurinë e tyre shoqërore dhe mirëqenien social-kulturore dhe ekonomike. Arma demokratike, d.m.th. e drejta për grevë, shihet se merr legjitimitet; mirëpo, me një ndryshim: pronarët e fabrikave dhe të kapitalit mbahen përgjegjës për sigurimin e punës dhe për të zhvilluar një sistem ku të drejtat e të dobtëve janë të sigurta në duart e më të fortëve.

Përveç kësaj, Ajetullah Khomeini mbronte një sistem të mbështetur mbi urdhrin hyjnor. Ai i paraljmëronte njerëzit që të mos binin pre e propagandës së cilitdo lloj, duke thënë: “Fjala ime e fundit për Kuvendin dhe Këshillin e Mbikëqyrësve, qeverinë, presidentin dhe Gjykatën e Lartë, është t’u bëj thirrje atyre që të mbështeten mbi verdiktet hyjnore, t’i bëjnë ballë rënies pre e propagandës boshe të kapitalistëve dhe komunistëve të pafe, ta njohin dhe ta respektojnë pronën private të ligjshme dhe kapitalin privat të arritur brenda kufijve të Islamit dhe t’i bindni njerëzit për njohjen tuaj të privilegjeve të tilla që kapitali privat të investohet në veprimtari prodhimtare, që të kontribuojë në vetëmbështetjen e qeverisë dhe të vendit si në industrinë e lehtë ashtu edhe në atë të rëndë. Përveç kësaj, fjala ime e fundit për të pasurit dhe zotëruesit e pasurisë së fituar ligjshëm është që t’i investojnë këto para në shëndetësi, në fermat, fabrikat dhe fshatrat tona, duke qenë të bindur se kjo nismë është një akt i lartë adhurimi.”¹³

Kështu, Ajetullah Khomeini thekson:

- i) investim të kapitalit privat
- ii) arritjen e vetëmjaftueshmërisë
- iii) zhvillimin e industrive të lehta e të rënda
- iv) investim në nisma që prodhojnë të mira dhe shërbime ndaj mirëqenies së vërtetë njerëzore
- v) investim në fermat për të zhvilluar fshatrat (ekonominë rurale) dhe investim në fabrika që prodhojnë të mira konsumi dhe për prodhim të mëtejshëm.

Megjithatë, ai nuk parashtron kapitalizmin e pakontrolluar që i gllabëron tërë rezervat në dëm të shumicës së njerëzve, duke i deprivuar të nëpërkëmburit dhe masat e shtypura. Ai thekson se: “Një nga temat që duhen trajtuar këtu është se Islami nuk e miraton kapitalizmin tiran, që priret t’i deprivojë të shtypurit dhe të nëpërkëmburit. Përkundrazi, ai e dënon atë prerazi në Kuran dhe në Traditën Profetike. Ata e konsiderojnë atë të kundërt me drejtësinë shoqërore; megjithëse ca njerëz me mendje gjysmake të cilët janë të painformuar për qeverisjen islame dhe çështjet politike në një shtet islam, kanë pretenduar dhe vazhdojnë akoma në shkrimet dhe ligjëratat e tyre se Islami parashtron kapitalizmin dhe pronën private të pakontrolluar, dhe me interpretime të tilla të diktateve islame ata ia kanë ndotur fytyrën e ndritshme Islamit, duke ua shtruar rrugën për invazion kundër Islamit njerëzve keqdashës dhe për të shpifur se pushteti islam është sikurse pushtetet kapitaliste të Perëndimit, si Shtetet e Bashkuara, Anglia dhe plaçkitësit e tjerë perëndimorë. Ka të tjerë që, duke u mbështetur mbi gjykimin e njerëzve të tillë mendjehetë, ose mbase me keqdashje dhe pa u trazuar që ta verifikojnë këtë te njohësit e vërtetë të Islamit, luftojnë Islamin. Por në skajin tjetër Islami nuk është sistem qeverisjeje si komunizmi dhe marksizëm-leninizmi, që dënojnë pronën private dhe që parashtrojnë pronën e përbashkët me shkallë të ndryshme dhe të cilët kanë kaluar disa shndërrime viteve të fundit, duke autorizuar madje poliandrinë dhe homoseksualitetin nën diktaturë absolute, mirëpo (një qeveri islame) është një sistem i moderuar qeverisjeje që e njeh pronën private në nivelin e të lejuarit të saj brenda kufijve, implementimi i të cilit në formën e tij të vërtetë do të sigurojë vazhdimin e një ekonomie të shëndoshë që lypset për sisteme politike të shëndosha.”

“Ndërkohë të tjerët, duke u mbështetur mbi interpretimin e tyre të shtrembët të Islamit dhe në sajë të mungesës së thellimit të tyre në Islam dhe në ekonominë e shëndetshme që ai parashtron, kanë zgjedhur një pozicion që është në skajin tjetër, duke nxjerrë madje aty-këtu edhe vargje nga Kurani e pjesë nga Nehxhul Belaga. Ata pretendojnë se Islami është i përputhshëm me shkollat të tilla të devijuara si marksizmi, duke i shpërfillur vargjet e tjera të Kuranit të Shenjtë dhe të Nehxhul Belagës, duke parashtruar pronën e përbashkët sipas vështrimit të tyre miop, dhe duke mbështetur përdhosjen, diktaturën dhe mbytjen e masave nga një grusht njerëzish që sillen si kafshë.”¹⁴

Dikotomia urbane-rurale, nëse nuk trajtohet me masat e duhura, ka pasoja katastrofale mbi krejt procesin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Kujdesi i qendrave urbane dhe gjithashtu ai i elitës urbane, çon në përqendrimin e pasurisë dhe privilegjeve në disa duar, kur miliona dergjen për drejtësi social-ekonomike. Duke cekur gjendjen gjatë regjimit të Pahlaviut dhe duke ravijëzuar politikën e ardhshme të Republikës

Islamike, Ajetullah Khomeini shkruante: “A nuk e dini se atëherë shërbimet e zhvillimit ishin privilegj pothuajse krejtësisht e qyteteve, dhe edhe atje madje e sektorit të kamur të qyteteve ku të varfrit e të deprivuarit përfitonin fare pak, nëse jo aspak, nga ato shërbime. Kurse qeveria e sotme si dhe institucionet islame ofrojnë shërbime për ato grupe njerëzish të deprivuar, me plot zemër. Prandaj, edhe ju o njerëz të përzoztshëm, mbështeteni qeverinë që projektet të vihen në jetë sa më shpejt, dhe shpresoni që në rrugën tuaj drejt parajsës të mbartni shenjën e shërbesës ndaj njerëzve të Zotit.”¹⁵

Mirëqenia e të deprivuarve, të tiranizuarve dhe të shtypurve (në mbarë botën) ishte aq e shtrenjtë për zemrën e Ajetullah Khomeinit saqë ai i cekte këto çështje pareshtur: “Dhe, dua ta këshilloj Kuvendin, qeverinë dhe administratën për të çmuar meritat e këtij kombi dhe për t’u shërbyer atyre dhe sidomos masave të shtypura e të tiranizuara që janë drita e syve tanë dhe mirëbërësit e të gjithëve, që e ngritën Republikën Islamike në sajë të veprave të tyre të vetëflijimit; mbijetesa e të cilëve është, gjithashtu, rezultat i shërbesave të tyre.”¹⁶

Ajetullah Khomeini mbronte një rend vërtet të paangazhuar, ta pavarur, si nga Perëndimi, ashtu edhe nga Lindja e sistemet dhe organizatat e tyre arrogante. Ai parashtronte një rend socio-ekonomik që është vërtetësisht i angazhuar me Islamin, sepse “Islami është feja e madhe e unitetit. Ai shkatërron paganizmin, idhujtarinë dhe egoizmin. Ai është një besim që mbështetet në natyrën e njeriut (*fitreh*). Ai e çliron njeriun nga prangat dhe vargonjtë e natyrës dhe nga xhinnët që janë edhe të fshehur edhe të dukshëm... Islami nuk është as lindor, as perëndimor.”¹⁷

Mirëpo sistemet dhe kombet kultivohen, fuqizohen dhe zhvillohen vetëm kur rinia, që përbën trungun kryesor të popullatës punuese, të sillet me përgjegjësi. Gjendja bëhet e vështirë kur kjo rini demoralizohet. Ajetullah Khomeini, duke përshkruar kushtet e Iranit të Pahlaviut, tha: “.. Në një tjetër invazion, ata krijuan vende për ta demoralizuar rininë tonë. Në këto vende që i magjepsnin dhe i tërhiqnin të rinjtë, ata dalëngadalë e humbisnin identitetin e tyre. Në Tehran kishte më tepër vende shthurje sesa librari. Ata e deprivuan dhe e zhveshën rininë nga fuqia karakterizuese e të rinjve në mënyrë që duke e devijuar rininë tonë nga aftësitë e tyre të nevojshme, ata mund të plaçkisnin më mirë pasurinë tonë në sytë e njerëzve indiferentë..”¹⁸ Sepse “.. një i ri që krijon shprehi me gjëra të tilla dhe nuk mendon më tej se kush po na e grabit naftën, çelikut, gazin, thotë: Ç’më duhet mua? Më lini rehat në qejfet e mia. Se mos kam kohë për të humbur unë, duke u marrë me këto punë.”¹⁹ Por, kur zemra ndriçohet, thonte i nderuari Ajetullah “ajo nuk mund të heshtë dhe të shikojë se si ia shkulin traditën dhe nderin. Një zemër e ndriçuar nuk mund ta shohë popullin duke u çuar në nivele të ulëta shpirtërore ose të vështrojë në heshtje që individë përreth Teheranit të jetojnë në baraka... Ata nuk pyesin veten pse këta njerëz të skamur kanë mbetur në varfëri dhe përse të tjerët e marrin naftën tonë. Atyre as nuk u shkon ndërmend se ne kemi probleme të tilla.”²⁰

Për të ndihmuar që të arrihet një zhvillim i vetëmbështetur dhe një ekonomi e sistem shoqëror i mirëadministruar, ai theksoi një arsimim të barazpeshuar mirë për të rinjtë, duke thënë se “...universitetet duhet t’u sigurojnë arsimim të duhur të rinjve nëse administratat e tyre kanë besim në Islam. Duhet të bëjmë çmosin që t’ia largojmë rinisë

këtë frymë që njihet si ‘toksikim me Perëndimin’.”²¹ Kështu, ai e vinte theksin mbi zhvillimin e burimeve njerëzore.

Përgjegjësia e nxitjes së një zhvillimi të shëndoshë dhe të barazpeshuar ekonomik duhet të ndjehet si nga gratë, ashtu edhe nga burrat, në një shoqëri. Ajetullah Khomeini u dha rol me përgjegjësi edhe grave, duke thënë: “... Ato gëzojnë një pjesë të madhe tani në arsimim dhe edukim, qoftë në edukimin e fëmijëve të tyre qoftë në atë të klasave dhe vendeve të tjera.” “... Më e rëndësishme se kjo është fakti se pas fitores së Revolucionit, gratë, me arsimimin, trajnimin, punën e fortë dhe ruajtjen e pastërtisë së urdhëresave islame jo vetëm që hodhën hapa të mëdhenj por ishin pioniere në çështjet e kombit.” Dhe “sot, ne dëshmojmë që gratë e respektuara të Iranit në mbarë vendin janë pjesëtare të dobishme, të përkushtuara dhe të devotshme që po ia ofrojnë shërbimet atdheut të tyre dhe që po e mbështesin këtë vend ... ato kanë edukuar të rinjtë dhe i kanë dërguar ata në fronte.”²²

Konceptet e theksuara më sipër janë në kontrast me Iranin para Revolucionit ku pabarazi të mëdha e ndanin popullatën në ‘të kamur’ dhe në ‘të skamur’. Të ardhurat, pasuria dhe mundësitë e tjera ishin të shpërndara në mënyrë të pabarabartë duke shpjer në shfrytëzim dhe shtypje. Vërtet, të gjitha diskutimet dhe veprimet për të vendosur një shoqëri të drejtë humane dhe një rend të ri ekonomik ndërkombëtar duhet ta nxjerrin mbështetjen e tyre nga besimi i njeriut në mirësi duke e çrrënjësuar shfrytëzimin e njeriut nga njeriu në të gjitha format dhe manifestimet e tij. Kjo arrihet vetëm nëse besojmë se njerëzimi nuk është tjetër veçse një familje, e krijuar dhe e furnizuar nga Një Zot, dhe besimi i zbratur nga praktika humbet shumë nga hijeshia e tij. S’është çudi që sot, feja po konsiderohet gjithnjë e më tepër si ‘burim’. Ai që ka besim në Zot, duhet të shmangë padrejtësinë në të gjitha format e saj.

Republika Islamike ka për synim që të bëjë një përdorim të duhur të fuqisë së qytetarëve të saj për të ndihmuar zhvillimin dhe vazhdimin e rendit socio-ekonomik për të ndërtuar një ekonomi që funksionon lëmueshëm – një ekonomi ku në afate të gjata, shpresohet se nuk do të ketë as shfrytëzues e as të shfrytëzuar. Punësuesit dhe punëtorët, prodhuesit/shitësit dhe konsumatorët, dhe të gjithë të tjerët që punojnë në administratë e në ndërmarrje industriale, do të jenë të aftë të kryejnë përgjegjësinë e tyre para Zotit dhe njeriut, për të ndihmuar zhvillimin e një rendi të ri socio-ekonomik që do të jetë vetëmbështetës, ku besimi do të jetë shpirti frymëzues që qëndron pas të gjitha veprimeve. Politikat zhvilluese që janë hartuar sipas urdhrit kuranor:

“... shkalla e lulëzimit të një individi os ekombi varet krejtësisht nga puna e tij”

do të shpërblehet patjetër. Duke patur si spirancë besimin, veprat do të maten nga besimi dhe zhvillimi ekonomik do të jetë pa shfrytëzim të cilitdo lloj.

Planifikimi i Republikës Islamike mbështetet në autoritetit fetar që u prezantua nga Ajetullah Khomeini në “kulmin e shtypjes dhe mbytjes nga regjimi kolonialist, dhe ai krijoi motivimin e ri karakteristik të popujve muslimanë dhe e zgjeroi udhën fisnike të përpjekjes së shkollës së Islamit e cila, nga ana e vet, e çoi luftën e luftëtarëve të përkushtuar muslimanë si brenda ashtu edhe jashtë vendit.”

Por, në asnjë mënyrë nuk duhet keqkuptuar se pushteti islam nuk do të punojë për mirëqenien materiale të popullit. Përkundrazi, duhet të kuptohet qartë se “në Islam, ekonomia është një mjet që synon të jetë një pjesë e punës së përmirësimit dhe mjeti nuk mund të bëhet qëllim.”²³

Kështu, mund të konkludohet se Ajetullah Khomeini parashtronte themelimin e një rendi të tillë socio-ekonomik që nuk ka as shfrytëzues, as të shfrytëzuar; ku të drejtat e të dobëtve janë të sigurta në duart e të fortëve; ku nuk ka privilegje pa vend, e as grupe të veçanta që jetojnë me punën e të tjerëve; ku ka kthim të drejtë të djersës dhe mundit të punëtorëve; ku kapitali vjen nga pasurimi i ekonomisë; ku ka zhvillim socio-ekonomik për t’i shërbyer Zotit dhe njeriut; ku prosperiteti është për të disiplinuar masat, e jo për t’i devijuar ato në humbje; ku besimi është spiranca dhe të përzotshmit e veprat e mira e çojnë njerëzimin në rrugë të drejtë, në dritën e Kuranit të Shenjtë dhe Praktikës së Profetit (pqmt) dhe ku veprat e jetët e Imamëve të Familjes së Profetit (pqmt) janë udhërrëfyesit për rrugën drejt suksesit në këtë botë dhe në të përtejmen.

Referenca:

1. Ajetullah Khomeini në përgjigje të përhëndetjeve të ambasadorit çek me rastin e dy-vjetorit të fitores sëë Revolucionit Islamik të Iranit, 11 Shkurt 1981, *Selected Messages and Speeches of Imam Khomeini*, Ministry of Islamic Guidance and Islamic Culture, Tehran, 1982, f. 33.
2. *Imam's Final Discourse*, Ministry of Guidance and Islamic Culture, Tehran, f. 29.
3. po aty, f. 30
4. po aty.
5. Mesazhi i Imam Khomeinit në Medresenë Fejzije të Komit, me rastin e masakrës së 17 Shahrivarit (Shtator 1988) të vitit të shkuar, *Selected Messages*, f. 29
6. *Imam's Final Discourse*, Ministry of Guidance and Islamic Culture, Tehran, f. 32.
7. po aty, f. 42.
8. po aty, f. 47.
9. po aty, f. 48
10. po aty
11. Imam Khomeini, Lajmërimi Radio-Televiziv për vendosjen e Republikës Islamike të Iranit. *Messages and Speeches*, August 3, 1979, f. 9.
12. po aty, f. 10
13. *Imam's Final Discourse*, f. 59.
14. po aty, ff. 58-59.
15. po aty, f. 58
16. po aty, f. 27
17. Imam Khomeini, Message for the Gathering of the Hajj, 1399 H; *Selected Messages*, f. 40.
18. Imam Khomeini, Speech to the Representatives of the World Liberation Movements, January 10, 1979, *Selected Messages*, f. 92.
19. Imam Khomeini, Message in the Faiziyah Madrasa, September 8, 1979, *Selected Messages*, f. 31.
20. po aty, f. 31
21. Shih 18, ff 92-3
22. Imam Khomeini, Speech to the Women Members of Isfahan University, May 24, 1981. *Selected Messages*, ff. 45-6
23. Kushtetuta e RI Iranit.